UDHËZUES

METODAT E LLOGARITJES SË **KOSTOS** DHE **TARIFËS** NË **MENAXHIMIN E MBETJEVE TË NGURTA** NË NIVEL NJËSIE TË QEVERISJES VENDORE NË SHQIPËRI

dldp
decentralisation and local development programme

Funded by
Schweizerische Eidgenossenschaft
Confederation suisse
Conderazione Svizzera
Confederaziun svicra
Swiss Agency for Development And Cooperation SDC

HELVETAS Swiss Intercooperation | ALBANIA

UDHËZUES

Metodat e llogaritjes së Kostos dhe Tarifës
në Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta
në nivel Njësie të Qeverisjes Vendore në Shqipëri

2013

Përgatitur në kuadër të Programit për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp)

Zhvilluar nga
Eduart Cani,
Qendra Rajonale e Mjedisit (REC), Shqipër

Në bashkëpunim me
Felix Schmidt dhe Emilie Gex
CSD INGENIEURS SA

Me mbështetjen e
Valbona Karakaçi dhe Arben Kopliku
Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp)
HELVETAS Swiss Intercooperation

Shqipëri, Dhjetor 2013

Ky është një version i konsoliduar i dy manualeve të veçantë për koston dhe tarifën, të zhvilluara dhe pilotuara në nivel të njësisë vendore gjatë periudhës 2012-2013.
Ky version i publikimit është konceptuar për përdorimin nga ana e zyrtarëve dhe ekspertëve në nivel kombëtar dhe lokal, si një dokument pune.

Përmbajtja

Hyrje **5**

PJESA I -
Udhëzuesi për llogaritjen e kostos për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta **7**

1. Dispozitat e përgjithshme të modelit të llogaritjes **9**

1.1 Të dhënat e përgjithshme për zonën administrative [BLLOKU 1] 10

1.2 Investimet kapitale [BLLOKU 2] 13

1.3 Kostot operative [BLLOKU 3] 15

1.3.1 Kostot e mirëmbajtjes [BLLOKU 3a] 16

1.3.2 Kostot e grumbullimit dhe transportit [BLLOKU 3b] 17

1.3.3 Kostot e personelit [BLLOKU 3c] 19

1.4 Kostoja për depozitim 'landfill' (tarifa e depozitimit) [BLLOKU 4] 22

1.5 Kostot e amortizimit të (ri-investimit) [BLLOKU 5] 23

1.6 Kostot administrative [BLLOKU 6] 23

1.7 Shumat e përgjithshme [BLLOKU 7] 24

1.8 Tab. 10 –Shembull – Sistemi i llogaritjes së kostos për menaxhimin e mbetjeve 26

2. Prezantimi i rezultateve **30**

3. Pëllogaritja e kostove për sezonin turistik **35**

4. Shtojcë - Sistemi i llogaritjes së kostos siç paraqitet në modelin në Excel **36**

PJESA II - Tarifat për menaxhimin e mbetjeve të ngurta. Një udhëzues për modele të ndryshme të Menaxhimit të Tarifave për NJQV-të në Shqipëri **55**

1. Hyrje **57**

1.1 Principet e vendosjes së tarifës 58

1.2 Kategoritë e adresuara / klientët 59

1.3 Përdoruesi i manualit / njësia e zbatimit 59

2. Zhvillimi i sistemit të përshtatshëm të faturimit **61**

3. Paraqitja e modeleve **64**

3.1 Modeli i bazuar në numrin e popullsisë / punonjësve 64

3.1.1 Përqasja që sjell modeli 64

3.1.2 Të dhënat e nevojshme 66

3.1.3 Prezantim i detajuar i modelit (modeli i zhvilluar plotësisht në excel, bashkëlidhur) 66

3.1.4 Përllogaritja e tarifës individuale 70

3.2 Modeli i bazuar në sipërfaqen e pronës 70

3.2.1 Përqasja që sjell modeli 70

3.2.2 Të dhënat e nevojshme 72

3.2.3 Prezantim i detajuar i modelit (modeli i zhvilluar plotësisht në excel, bashkalidhur) 72

3.2.4 Përllogaritja e tarifës individuale 76

3.3 Modeli progresiv 77

3.3.1 Përqasja që sjell modeli 77

3.3.2 Të dhënat e nevojshme 78

3.3.3 Prezantim i detajuar i modelit (sipas modeli të zhvilluar plotësisht në excel) 80

3.3.4 Shpjegimi i faktorëve të përdorur në tabelat më sipër dhe mënyra e përdorimit të tyre 83

1. Hyrje

Menaxhimi financiar i sektorit të mbetjeve të ngurta është një çështje sfiduese. Në këtë aspekt, programi për decentralizim dhe zhvillim lokal -dldp, në kuadër të përmirësimit të qeverisjes lokale nëpërmjet ofrimit me qëllim përmirësimin e shërbimeve publike mbështet konsolidimin e sektorit të menaxhimit të mbetjeve të ngurta në nivel rajonal dhe lokal në Shqipëri.

Korniza legjislative e menaxhimit të mbetjeve të ngurta është plotësuar mjaftueshëm që nga viti 2011, me miratimin e ligjit kornizë për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe në aktet nënligjore, të cilat janë zhvilluar vazhdimisht , megjithëse mbetet ende shumë punë në forcimin dhe zbatimin e tij. Në vitin 2013 shërbimi në vetvete është plotësisht në duart e Njësive të Qeverisjes Vendore, ndërsa korniza legjislative dhe rregullative është e shpërndarë në nivele të ndryshme të qeverisjes.

Aktualisht (2013), sistemi i kostimit të shërbimit dhe menaxhimi tarifor nuk janë të rregulluara apo të monitoruara nga ndonjë autoritet qendror, por nga vetë njësitë e qeverisjes vendore, bazuar në njohuritë dhe kapacitetet e tyre më të mira. Bazuar në mbështetjen e dhënë në dy dekadat e fundit nga agjencitë ndërkombëtare dhe kapacitetet e zhvilluara në nivel lokal, modelet e aplikuara për kostimin dhe vendosjen e tarifave janë të ndryshme në NjQV të ndryshme.

Ky manual paraqet një qasje të konsoliduar për menaxhimin financiar të shërbimit të mbetjeve të ngurta, duke siguruar një burim të mirë për zyrtarët në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal në Shqipëri. Ai është zhvilluar si një mjet praktik dhe i gatshëm për t'u përdorur, duke siguruar njëkohësisht njohuri profesionale dhe teknike për përdoruesin (në këtë rast zyrtarët e NjQV).

Dokumenti është i përbërë nga dy pjesë kryesore:

- **PJESA I: UDHËZUESI PËR LLOGARITJEN E KOSTOS PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE TË NGURTA**
- **PJESA II: TARIFAT PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE TË NGURTA. NJË UDHËZUES PËR MODELE TË NDRYSHME TË MENAXHIMIT TË TARIFAVE PËR NJQV-TË NË SHQIPËRI**

Të dy Pjesët i drejtojnë përdoruesit në sistemin e zhvilluar bazuar Excel për llogaritjen e Kostos dhe Menaxhimin e Tarifave (modelet në Excel janë zhvilluar plotësisht nga programi dldp, por nuk janë përfshirë në këtë version të botimit)[1]. Ato ofrojnë njohuri për përdorimin e variablave dhe modele të ndryshme, të cilat mund të ndryshojnë sipas qasjeve të ndryshme në organizimin e shërbimit. Kuptimi i këtyre ndryshimeve do t'i shërbejë NJQV-ve në llogaritjen e kostove të brendshme dhe të jashtme, përdorimin e teknologjive më të mira dhe në qasjet më të mira në rikuperimin e kostos.

Ky manual është bazuar në praktikën dhe njohuritë e mira ndërkombëtare dhe përafruar me realitetin shqiptar, veçanërisht në aspektin e ekzistencës së të dhënave / disponueshmërinë dhe kapacitetet e zhvillimit të këtyre të dhënave. Ai, gjithashtu, merr në konsideratë zhvillimet aktuale të vendit në disa sektorë, të cilat kanë ndikim në menaxhimin e mbetjeve të ngurta.[2]

1) Sistemet përfundimtare të zhvilluara në Excel për Llogaritjen e Kostos dhe Modelimin e Tarifave, do të shpërndahen pasi të jenë është pranuar dhe miratuar nga autoritetet kombëtare si modele pune. Versione të tyre mund [illegible]hi ne faqen e prog[illegible]it dldp (www.dlp.al)

2) Përjashtim nga përgjegjësia
Modelet aktuale të llogaritjes së Kostos dhe Tarifës janë zhvilluar si një mjete për të ndihmuar NJQV-të në përllogaritjen kostove dhe tarifave në nivel vendor.
Modelet duhet të përdoret vetëm nga profesionistët pasi kanë marrë një trajnim të veçantë të përdorimit të tyre.
Rezultatet duhet të analizohen me një kujdes profesional dhe bazuar në përvojë para se të mbërrijnë në ndonjë përfundim apo vendim. Autorët supozojnë se rezultatet e këtyre modeleve nuk do të përdoren për një qëllim tjetër ndryshe nga ai i rënë dakord dhe nuk mund të zbatohen për arsye të tjera, shtet apo rrethanat të ndryshme.
Autorët nuk marrin asnjë përgjegjësi për ndonjë vendim të bazuar në rezultatet e modeleve, të marra pa pjesëmarrjen aktive të tyre.
Nëse një palë e tretë përdor rezultatet e këtij modeli në mënyrë që të marrë vendime, autorët hedhin poshtë çdo përgjegjësi për çdo lloj dëmi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë (që rrjedh prej). Çdo përdorues i këtij modeli konsiderohet se i ka pranuar këto kushte.

PJESA I

Udhëzuesi për llogaritjen e kostos për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta

1. Dispozitat e përgjithshme të modelit të llogaritjes

Një sistem standard i llogaritjes së kostos për menaxhimin e mbetjeve për një NJQV të vetme duhet të bazohet në blloqet e përgjithshme të mëposhtme[3]:

- **Të dhënat e përgjithshme për zonën administrative**
- **Investimet kapitale (kamionët dhe kazanët e nevojshëm)**
- **Kostot operative (mirëmbajtje, transport dhe personel)**
- **Kostoja për depozitim 'landfill' (tarifa e depozitimit)**
- **Kostot e amortizimit (ri-investimit)**
- **Kostot administrative**

Të gjitha blloqet e mësipërme dhe elementet përkatëse që i popullojnë ato, janë modeluar në sistemin në një sistem në Excel (referoju shtojcave për paraqiten në detaje të këtij sistemi) në formën e një sistemi të zgjuar, i cili është në gjendje të ofrojë të gjithë infrastrukturën përkatëse, burimet njerëzore dhe mjetet financiare të nevojshme për funksionimin e sistemit të menaxhimit.

Çdo bllok është përshkruar në detaje më poshtë, për mënyrën e përdorimit dhe bashkëveprimin që realizohet në sistem. Administratori për menaxhimin e mbetjeve duhet të jetë në gjendje të përdorë sistemin dhe kuptojë se si është zhvilluar ai, në mënyrë që të jetë në gjendje të interpretojë rezultatet dhe për ta zhvilluar atë më tej, bazuar në ndryshimet në variablat dhe kostot standarde.

3) Modeli më tej mund të përfshijë: **Parandalimin**, sasia e mbetjeve në përqindje, e cila reduktohet në burim; **Ripërdorimin dhe riciklimin**, sasia e mbetjeve e cila është kanalizuar jashtë sistemit të kostos së përgjithshme; **Rehabilitimin**, në lidhje me mbylljen e venddepozitimeve aktuale apo vendeve të tjera të ndotura. NJQV-ja mund të kërkojë fonde të jashtme ose të zhvillojnë skema të parneritetit publik-privat për të adresuar këto aspekte.

Kuti 1: Para se të nisni

Para se të filloni të përdorni një sistem të menaxhimit të kostos, duhet të mblidhni një grup të dhënash, të cilat kanë të bëjnë me popullsinë, gjeografinë, llojet e rrugëve dhe kushtet e tyre (potencialisht një hartë GIS, ose mund të përdorni hartat e Google), tipet e kamionëve, kazanëve, kostot aktuale të karburanteve, sistemin e pagave. Një grumbullim modern i të dhënave do të bazohej në sistemin e standardizimit (benchmarking), i cili mund të zhvillohet në shkallë të vogël në nivel vendor. Ekzistenca e planit vendor të menaxhimit të mbetjeve është vendimtar para fillimit të llogaritjes së kostove, pasi ai do të sigurojë shumicën e informacionit teknik dhe infrastrukturor të nevojshëm për variablat e sistemit.

Shumica e të dhënave mund të mblidhet duke iu referuar strategjive ekzistuese kombëtare dhe rajonale, bazave të të dhënave, referencave dhe raporteve, ndërsa disa prej tyre, të tilla si sasia e mbetjeve për frymë, distanca rrugore dhe kushtet, numri i njësive prodhuese të mbetjeve, duhet të llogariten dhe mund të kërkojnë vrojtime dhe vlerësime.

1.1 Të dhënat e përgjithshme për zonën administrative [BLLOKU 1]

Qëllimi i këtij blloku është të përcaktojë situatën dhe vlerësojë nevojat për investime kapitale, operacione, personel dhe çështje të tjera administrative.

Variablat kryesore të përdorura për këtë bllok janë: a) tipi i NjQV-së; b) nr. i popullsisë, c) vizitorët dhe turistët d) distancat rrugore, d) sasia e mbetjeve të gjeneruara.

Më poshtë, ne do të ofrojmë disa shpjegim të ndryshueshmërisë së çdo variabli:

a) Tipi i NjQV-së. Konsideron ndarjen e qartë të NJQV-ve në, ato Urbane dhe Rurale. Ky variabël është i rëndësishëm për përcaktimin (bazuar në Strategjinë Kombëtare të Mbetjeve dhe përvojën) e sasisë së mbetjeve të gjeneruara, tipin e kamionëve, distancat, personelin dhe të gjitha kostot e lidhura me këto.

b) Popullsia (Nr. i banorëve). Një popullsi tipike e një NJQV-je do të përbëhej nga banorët rezidentë dhe banorët sezonale (turistë/vizitorë), të cilët duhet të merren në konsideratë më vete. Numri i rezidentëve mund të vlerësohet nëpërmjet regjistrit civil. Por ka shembuj të banorëve të regjistruar, të cilët nuk jetojnë në të vërtetë në zonën administrative të Njësisë (të tillë si emigrantët, studentët, etj.) dhe nuk duhet të konsiderohen gjatë llogaritjes.

Në modelin e paraqitur në shtojcat, ne tregojmë se si zbresim nga banorët e regjistruar ata që nuk jetojnë në zonë duke zbatuar një përqindje mesatare, bazuar në dijeninë e NJQV-së.

c) Vizitorët dhe turistët (Nr. i vizitorëve të përditshëm). Këta gjenerues mbetjesh duhet të konsiderohen veçmas, pasi ata janë të pranishëm vetëm në një periudhë të caktuar të vitit. Konsiderimi i kësaj popullate duhet të kufizohet në NjQV-të, për të cilat sezoni turistik ka një ndikim të rëndësishëm në menaxhimin e mbetjeve. Këto të fundit duhet të shënojnë numrin e vizitorëve të përditshëm dhe kohëzgjatjen (muajt) zyrtare të sezonit turistik.

Kuti 2: Vizitorët dhe turistët

Llogaritja e numrit të turistëve/vizitorëve, të cilët mund të variojnë nga mijëra (vendet historike, natyrore) në qindra mijëra (rezortet pranë detit, turizmi masiv), duhet të llogaritet veçmas, në mënyrë që mos të bëhen barrë për familjet.

Një sistem i veçantë për menaxhimin e mbetjeve të ngurta të prodhuara gjatë pikut të sezonit turistik është zhvilluar (sistemi bashkëlidhur) për të identifikuar kostot përkatëse me të cilat duhet të faturohen turistët. Këto kosto janë konsideruar si kosto shtesë.

d) Distancat dhe kushtet rrugëve (në km). Normalisht një kamion që grumbullon mbetjet duhet të vizitojë të gjithë zonën administrative (pikat e grumbullimit), duke udhëtuar përreth derisa kamioni të mbushet plot, më tej të drejtohet në fushë depozitimi 'landfill' dhe të kthehet përsëri, gjë që mund të përkojë me një turn ose përfundimin e shërbimit të grumbullimit për një ekip. Gjendja e rrugëve është shumë e rëndësishme pasi kjo do të lidhet kryesisht me konsumin dhe kostot e amortizimit dhe për më tepër me kohën e shpenzuar për grumbullimin. Rrugët shtruara do të përmirësonin shumë shërbimin e grumbullimit të mbetjeve. Distancat për t'u marrë në konsideratë janë:

1) Distanca për grumbullimin, për të mbushur një kamion

2) Distanca për transportin, për të shkuar dhe kthyer nga fusha e depozitimit 'landfill'.

e) Sasia e mbetjeve të gjeneruar (kg/frymë). Kjo përbën një variabël real, i cili përditësohet bazuar në verifikimet në terren. Bazuar në studime, sasia e mbetjeve për frymë ndryshon nga 0,6kg/frymë në zonat rurale në 0,8-1kg/frymë për zonat urbane. Ka përjashtime për NJQV-të me numër shumë të vogël të popullsisë dhe të vendosura

në zona shumë të thella, ku ky numër duhet të verifikohet dhe mund të rezultojë më i ulët se 0,3kg/frymë, dhe për disa zonat urbane të mëdha, ku kjo shifër mund të jetë më shumë se 1kg/frymë.

Të gjitha shifrat e mësipërme kanë të bëjnë me mbetjet e ngurta urbane, duke mos përfshirë mbetjet e rrezikshme, ato bujqësore, inertet dhe mbetjet voluminoze, të cilat duhet të trajtohen veçmas në bazë të standardeve për operacionet.

Si vlerësim në pamje të parë, sugjerohet që të merret në konsideratë një numër mesatar prodhimi mbetjesh për banor, që përfshin gjithë mbetjet e gjeneruara, e cila përfshin brenda vetes dhe prodhimin e mbetjeve nga familjet, institucionet dhe bizneset.

Sasia e gjenerimit të mbetjeve për frymë është shifra më e rëndësishme që ndikon në gjithë sistemin. Prandaj NJQV-ja duhet të verifikojë prodhimin e vërtetë duke peshuar mbetjet bazuar në një plan

Tab. 1 – Përdorni tabelën më poshtë për të ndërtuar këtë bllok të sistemit të llogaritjes së kostos [TC 1]

Ref.	Zërat	Njësia matëse	Përdorimi i zërit	Komente
A	**Emri i NJQV**	*PA*	Treguese	PA
B	**Frekuenca e grumbullimit** *(numri i grumbullimeve për javë)*	*Numër*	Numër fiks	Kjo përllogaritet nga sasia e mbetjeve të prodhuara dhe zakonisht procedohet 2 ose 7 ditë në javë
C	**Tipi (Rurale, Urbane)**	*PA*	Text	Përdorir sipas ligjir, Urbane ose Rurale. Ndryshimi ndërmjet këtyre dy variablave përcakton dhe ndryshimet ne standarded e operimit.
D	**Popullsia** *(të regjistruar sipas censusis)*	*Numër*	Numër fiks	Vendos shifrën që merret nga regjistri i gjendjes civile, pavarësisht numrit faktit të banuesve gjatë gjithë vitit.
E	*% e popullsisë e përjashtuar (regjistruar por që jetojnë jashtë/ emigrant)*	*%*	Numër fiks	NUmri i popullsisë së përjashtuar përbëhet zakonisht nga numri i emigrantëve, të cilat jetojnë në më shumë se gjysmën e vitit jashtë zonës administrative të komunës.
F	**Popullsia e shërbyer** *(që merr/konsiderohet për t'u shërbyer)*	*Numër*	Variabël	Kjo përllogaritet nga formula **D** *(minus)* **E.** Duke zbritur numrin e popullsisë së përjashtuar nga numri i banorëve të regjistruar.

Ref.	Zërat	Njësia matëse	Përdorimi i zërit	Komente
G	**Rrugët** *(distance nga fusha e depozitimit, një drejtim)*	*km*	Numër fiks	Zakonisht kjo distancë mbetet e njëjta për vite.
H	**Rrugët** *(dispatnca e përshkuar nga një kamion në një turn)*	*km*	Numër fiks	Kjo përllogaritet nga matjet në terren, duke vlerësuar distancën që përshkon kamioni deri sa mbushet, po pa kaluar një turn
I	**Standardi i gjenerimit të mbetjeve për person**	kg/ban.	Numër fiks	Përdor standarded e përcaktuar në planet e menaxhimit, por tregohu i kujdeshëm që të përditësosh të dhënat sipas faktit, pasi kjo shifër është më domethënësia në përllogaritje
J	**Totali i mbetjeve të gjeneruara**	*t/ditë*	Variabël	Përllogaritur nga formula **D * I/1000** për të përcaktuar totalin e mbetjeve në kg në ditë
K	**Sasia totale e mbetjeve të gjeneruara ndërmjet 2 grumbullimeve, bazuar në frekuencën e grumbullimit (B)**	*t*	Variabël	Përllogaritet nga formula. Nëse grumbullimi është çdo ditë, atëherë shifra është e barabartë me J, përndryshe, nëse është 2 herë në javë, përllogaritet sasia e mbetjeve që gjenerohet në ditët pa shërbim.
L	**Sasia totale e mbetjve të gjeneruar në vit**	*t/vit*	Variabël	Përllogaritur nga formula **J * 365 ditë**

1.2 Investimet kapitale [BLLOKU 2]

Qëllimi i këtij blloku është të krijojë infrastrukturën bazë fizike të menaxhimit të mbetjeve (kamionët dhe kazanët). Kjo bazohet në të dhënat e mbledhura në bllokun e parë, i cili do të trajtojë nevojën për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të ngurta të gjeneruara.

Si hap i parë, ne duhet të llogarisim sa kamionë dhe kazanë kërkohen për të menaxhuar mbetjet në mënyrën e duhur. Blerja e këtyre mjeteve përfaqëson investimin kapital.

Variablat e përdorur në këtë pjesë të sistemit janë: a) turnet b) kamionët për grumbullimin e mbetjeve c) kazanët.

Duke filluar nga ky bllok, do të jetë e mundur të llogariten kostot operative (kapitulli tjetër).

Këtu ne ofrojmë një shpjegim të variancës së çdo shifre:

f) Turnet (Nr). Kjo paraqet numrin e “turneve” që një kamion mund

të bëjë në një ditë, duke përfshirë grumbullimin dhe transportin në 'landfill' (vajtja dhe ardhja), në bazë të sasisë së mbetjeve për të mbledhur. Zakonisht është më efikase që të kryen minimumi 2 turne me një kamion.

a) Tipi i kamionit për grumbullimin e mbetjeve (ton) dhe çmimi (lekë). Kamionët tipikë për grumbullimin e mbetjeve janë vetëngjeshës me kapacitet 5 dhe 10 ton. Këta kamionë sugjerohen për t'u përdorur në varësi të tipit dhe popullsinë së njësisë. Normalisht një zonë rurale do të përdorte një kamion me kapacitet 5 ton, ndërsa një zonë urbane një tip kamioni me kapacitet 10 ton. Numri i kamionëve varion bazuar në sasinë e mbetjeve për t'u mbledhur dhe numrin e turneve të nevojshme për çdo kamion. Kapaciteti aktual i ngarkimit për një përbërje tipike mbetjesh është rreth 85% të kapacitetit total mbajtës të kaamionit (p.sh. një kamion 10 tonësh mbushet deri në 10*85%=8,5 ton).

b) Kapaciteti i kazanëve (ton) dhe **çmimi** (lekë). Një kazan tipik ka një vëllim 1.1m3, i cili ka një kapacitet prej maksimal mbajtës prej rreth 0,10 ton mbetjesh të ngurta, në qoftë se ne konsiderojmë një dendësi të përgjithshme prej 0.11 ton/m3 për mbetjet. Kjo dendësi është matur në Shkodër gjatë një fushate peshimi në vitin 2009 dhe është subjekt i ndryshimeve sipas përbërjes së mbetjeve. Kapaciteti i një kazani është në varësi të madhësisë së tij (vëllimi, m3) dhe dendësisë specifike të mbetjeve në kazan. Shifrat e dhëna mund të përdoren si një vlerësim paraprak. Numri i kazanëve të nevojshëm llogaritet duke marrë në konsideratë një përdorim të kufizuar të mbetjeve, kryesisht shtëpiake. Lloje të tjera mbetjesh si ato bujqësore, inertet apo ndonjë lloj tjetër mbetjesh "të mëdha" duhet të përjashtohen dhe eliminohen nga vetë prodhuesit.

Tab. 2 - Përdorni tabelën më poshtë për të ndërtuar këtë bllok të sistemit të llogaritjes së kostos [TC 2]

Ref.	Zërat	Njësia matëse	Përdorimi i zërit	Komente
A	**Tipi i kamionit**	*ton*	Numër fiks	Zakonisht këtu do të shfaqen tipi 5t ose 10t. përdorimi i këtij zëri është tregues.
B	**Kapaciteti mbushës i kamionit**	*ton*	Numër fiks	Përllogaritet nga formula 85% e kapacitetit mbajtës **(85% * A).** Kjo për shkak se mbetjet kanë densitet të ulët dhe krijojnë volum, e cila mbush kamionin pa mbërritur peshën.
C	**Turnet**	*Numër*	Variabël	Përllogaritur nga formula, duke konsideruar sasinë e mbetjeve të gjenruar **(T1C1-K)** dhe kapacitetin e kamionit, për të përcaktuar 1 ose dy turne ditore.

Ref.	Zërat	Njësia matëse	Përdorimi i zërit	Komente
D	**Kamionë (sasia)**	*Numër*	Variabël	Përllogaritur nga formula, duke konsideruar sasinë e mbetjeve të gjeneruar dhe numrin e turneve. Për NJQV-të e mëdha me mbi 50.000 banorë shtohet dhe një kamion rezervë në rast avarie.
E	**Kapaciteti i kazanëve**	*ton*	Variabël	Tipi i kazanëve më i përdorur është 1,1 m3, i cili mund të mjaë deri në 0,10 ton mbetje të ngurta. Por, kjo shifër është subjekt rishikimi, duke marrë parasysh se densiteti i mbetjeve është përcaktues për masën.
F	**Kazanë (total)**	*Numër*	Variabël	Përllogaritur nga formula, duke konsideruar sasinë e mbetjeve që gjenerohet dhe kapacitetin mbajtës të kazanëve.
G	**Kostoja e kamionëve** *(të gjithë kamionët)*	*Lek*	Variabël	Përllogaritur nga formula, duke konsideruar koston e një kamioni (kostoja merret nga tregu, mund të jetë kamion i ri ose i përdorur) duke e shumëzuar me numrin e kamionëve
H	**Kosotoja e kazanëve** *(të gjithë kazanët)*	*Lek*	Variabël	Përllogaritur nga formula, duke konsideruar koston e një kazani (kostoja merret nga tregu, mund të jetë kazan i ri ose i përdorur) duke e shumëzuar me numrin e kazanëve
I	**Totali i investimeve**	*Lek*	Variabël	Përllogaritur nga formula **(G + H)**

1.3 Kostot operative [BLLOKU 3]

Qëllimi i këtij blloku është të llogarisë kostot që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e infrastrukturës (në lidhje me kamionët dhe kazanët) dhe transportin, duke përfshirë koston e personelit. Këto janë kostot vjetore dhe janë të rëndësishme për t'u mbajtur të ndara, sepse janë të lidhura ngushtë me ndryshimet e tregut dhe inflacionin.

Variablat kryesore të përdorura për këtë bllok janë a) ditët në vit gjatë të cilave kryhet shërbimi; b) kostoja e karburantit

Këtu ne ofrojmë një shpjegim të variancës së çdo shifre:

a) Ditët në vit gjatë të cilave kryhet shërbimi (d). Konsideron numrin e ditëve në një vit, gjatë të cilave kryhet grumbullimi i mbetjeve. Kjo varet nga frekuenca e grumbullimit (2 herë në javë ose 7 herë në javë). Kjo lidhet ngushtë me sasinë e mbetjeve për t'u grumbulluar. Në thelb, nëse ka një prodhim prej rreth 3,5t mbetjesh në ditë, ekziston nevoja për shërbime të përditshme. Për një prodhim më pak se 3t/ditë grumbullimi mund të organizohet

një herë në 2 ose 3 ditë. Në rast se shërbimi nuk kryeht çdo sitë, numri i kazanëve të nevojshëm shtohet automatikisht për të pritur mbetjet që prodhohen. Bazuar në përvojë mund të përdorim dy mundësi: 7 ose 2 grumbullime një javë.

b) Kostoja e karburantit (lek). Kostot e karburantit ndikojnë shumë në kostot e përgjithshme të menaxhimit të mbetjeve. Konsumi i karburantit duhet të mbikëqyret së tepërmi dhe një plan i mirë i itinerarit, grumbullimit dhe transportit eficient paraqitet si një domosdoshmëri. Përveç kësaj karburanti është subjekt i ndryshimeve ndërkombëtare dhe inflacionit vendas. Administratorët duhet të llogarisin ndryshimet shumëvjeçare në çmimin e karburanteve dhe ta adresojnë atë në mënyrën e duhur.

1.3.1 Kostot e mirëmbajtjes [BLLOKU 3a]

Variablat kryesore të përdorura për këtë bllok janë: a) mirëmbajtja e kamionëve b) mirëmbajtja mekanike; c) parkimi

Këtu ne ofrojmë një shpjegim të variancës së çdo shifre:

a) Mirëmbajtja e kamionëve (lekë). Të gjitha automjetet janë subjekt i mirëmbajtjes së rregullt të kërkuar nga legjislacioni dhe të lidhura me ndërrimin vajit dhe filtrave, të gomave dhe punëve të tjera të nevojshme për mirëmbajtjen. Kostot që lidhen me kamionët janë shumë të larta dhe një plan i mirë për mirëmbajtjen duhet të jetë pjesë e manualit administrativ. Për më tepër, kostot e sigurimeve dhe taksave duhet të llogariten çdo vit dhe të integrohen në këtë variabël.

b) Mirëmbajtja mekanike (shërbimet) (l). Kjo bazohet në orët e punës së kamionit. Mirëmbajtja mekanike është e lidhur ngushtë me kushtet rrugore dhe përdorimin e kamionit gjatë shërbimeve të përditshme. Trajnimi i duhur dhe mbikqyrje e rregullut duhet të sigurohet për stafin operativ në mënyrë që të sigurohet mbajtja e këtyre kostove në nivelin më të ulët.

c) Parkimi (lekë). NJQV-ja sugjerohet që të përdorë tokën e vet për të krijuar një stacion parkimi. Do të ketë gjithmonë kosto që lidhen me mirëmbajtjen e parkimit, operacionet e brendshme, rojet etj.

Tab. 3 - Përdorni tabelën më poshtë për të ndërtuar këtë bllok të sistemit të llogaritjes së kostos [TC 3]

Ref.	Zërat	Njësia matëse	Përdorimi i zërit	Komente
A	**Sigurimet dhe taksat për kamionët**	*Lek/kamion/vit*	Numër fiks	Shifra vjen nga taksat kombëtare për tipin e kamionit të përdorur
B	**Vaj dhe filtra**	*Lek/kamion/vit*	Numër fiks	Vlera është e përcaktuar nga tipi i kamionit dhe përdorimi i kamionit në km
C	**Gomat**	*Lek/kamion/vit*	Numër fiks	Ndërrimi i gomave varet nga konsumi i tyre dhe mund të mos jetë në bazë vjetore.
D	**Mirëmbajtja mekanike**	*Lek/kamion/vit*	Numër fiks	Sasia e parave të kërkuar për mirëmbajtjen vjen nga përvoja dhe nga përdorimi.
E	**Parkimi**	*Lek/kamion/vit*	Numër fiks	Sasia e parave të kërkuara për parkimin bazohet në realitetin e njësisë. Nëse NJQV ka tokën e saj, mund të ulë kostot e parkimit duke ndartuar një park për të gjithë mjetet e të gjitha departamenteve.
F	**Kostot totale të mirëmbajtjes**	*Lek/vit*	Variabël	Përllogaritur nga formula (**SUM=A:E) * numri i kamionëve**

1.3.2 Kostot e grumbullimit dhe transportit [BLLOKU 3b]

Variablat kryesore të përdorura për këtë bllok janë: a) koha e shpenzuar; b) distancat e përgjithshme; c) konsumi i karburantit

h) Koha e shpenzuar (orë). Ka dy variabla të ndryshëm të përdorur këtu: a) koha e shpenzuar për grumbullimin dhe, b) koha e shpenzuar për transportin në 'landfill'. Përdorimi i këtyre shifrave është i ndryshëm për njësi urbane dhe rurale dhe në varësi të tipit të kamionit. Zakonisht për kohën e grumbullimit një kamion 5t do t'i duhen 3 orë për të përfunduar ndërsa një kamioni 10t do t'i duhen 4 orë. Koha e shpenzuar për transport ndryshon në varësi të distancës deri në 'landfill' dhe shpejtësisë së kamionit. Në 'landfill' kamionëve do t'u duhet një kohë shtesë për të shkarkuar me një mesatare prej 0,3 orësh/turn.

i) Distancat e përgjithshme (km). Kjo llogarit distancën për grumbullimin dhe atë për 'landfill'. Një sistem rrugor i mirë i brendshëm do të rezultojë shumë eficient për të reduktuar distancat e përgjithshme, kështu pra, më pak kohë dhe më pak karburant. Itinerari i rrugëve të brendshme të kamionëve sugjerohet të studiohet më përpara, për të mos përshkuar (nëse është e mundur) të njëjtat rrugë dy herë.

j) Konsumi i karburantit (l). Konsumi i karburantit varet nga tipi i kamionit dhe numri i shërbimeve. Nga përvoja konsumi për kamionë për grumbullimin e mbetjeve është përkatësisht: për kamionin 5t = 3l/orë, për atë 10t = 5l/orë. Konsumi për kamionë gjatë transportit është përkatësisht: për llojin 5t = 0.4l/km, për llojin 10t = 0.5l/km.

Për të qenë sa më të saktë dhe për të përcaktuar ku janë kostot kryesore (dhe kursimet e mundshme), këshillohet të ndahen kostot për grumbullimin (kur kamioni është duke u mbushur) nga kostot e transportit (kur kamioni është e plot dhe rrugës për në 'landfill').

Tab. 4 - Përdorni tabelën më poshtë për të ndërtuar këtë bllok të sistemit të llogaritjes së kostos [TC 3]

Ref.	Zërat	Njësia matëse	Përdorimi i zërit	Komente
A	**Ditë shërbim**	*ditë/vit*	Variabël	Përllogaritur nga formula, bazuar në ditët në shërbim, të cilat mund të jenë 365 ose 108
B	**Koha e nevojshme për të ngarkuar një kamion në një herë – Koha e grumbullimit**	*h*	Numër fiks (për një kamion)	Shifër e përcaktuar nga tipi i njësië (zakonisht për Urbane 4 orë, Rurale 3 orë)
C	**Koha e nevojshme për grumbullim (total)**	*h/ditë*	Variabël	Përllogaritur nga formula (nr. kamionë * kohë/kamion * nr. e turneve)
D	**Koha e nevojshme për shkarkim në fushë depozitimi**	*h*	Numër fiks	Vjen nga përvoja (0,3 h), por për t'u verifikuar sipas matjeve
E	**Sasia e karburantit të harxhuar gjatë grumbullimit**	*lt/ditë*	Variabël	Përllogaritur nga formula, duke konsideruarn shumë faktorë, të tillë si numri i kamionëve, turnet, koha për grumbullim, koha për shkarkim dhe normën e harxhimit të kamionit
F	**Sasia totale e karburanit të harxhuar gjatë gjithë vitit, vetëm për grumbullim**	*lt/vit*	Variabël	Përllogaritur nga formula, duke konsideruar normën e konsumit dhe kohën totale të shpenzuar nga të gjithë kamionët gjatë grumbullimit
G	**Shpejtësia e lëvizjes**	*km/h*	Numër fiks	Përcaktohet nga tipi i kamionit dhe gjendja e tij, si dhe nga cilësia e rrugëve
H	**Koha e harxhuar për transportimin në fushë depozitimi**	*h*	Variabël	Përllogaritur nga formula, bazuar në numrin e kamionëve, turneve dhe kohës së harxhuar për të shkuar në fushë depozitimi dhe kohën e shkarkimit

Ref.	Zërat	Njësia matëse	Përdorimi i zërit	Komente
I	**Koha totale e harxhuar për transportin (në një ditë/të gjithë kamionët)**	*h/ditë*	Variabël	Përllogaritur nga formula, duke konsideruar numrin e kamionëve, turneve dhe distancës nga fusha e deopzitimit *2 drejtime lëvizje
J	**Karburanti i harxhuar gjatë transportit**	*lt*	Variabël	Përllogaritur nga formula, duke konsideruar normën e konsumit dhe kohën totale për të gjithë kamionët gjatë transportit
K	**Sasia totale e karburantit të harxhuar gjatë të gjithë vitit, vetëm për transport**	*lt/ditë*	Variabël	Përllogaritur nga formula, duke konsideruar sasinë totale të karburantit të harxhuar gjatë transportit * çmimin e karburantit për lt

1.3.3 Kostot e personelit [BLLOKU 3c]

Qëllimi i këtij blloku është llogaritja e të gjitha kostove operative të personelit, por duke u kufizuar vetëm për shoferët dhe operatorët e kamionëve. Ky përfaqëson një bllok shumë kritik të sistemit, një komponent që duhet të trajtohet në mënyrë të përgjegjshme, i cili duhet të adresojë aspektet sociale dhe menaxhimin e përgjegjshëm.

Variablat e përdorur në këtë pjesë të sitemit janë: a) personeli; b) orët e punës; c) pagat.

Pavarësisht se shërbimi mund të ofrohet nga vetë njësia ose kontraktohet së jashtmi, personeli i punësuar duhet të mbikqyret gjithmonë nga administratorët e shërbimeve të NjQV-ve për të siguruar që kompania siguron eficiencë shërbimi (kohë, siguri, performancë të detyrës, etj.)

Këtu ne ofrojmë një shpjegim të variancës së çdo shifre:

a) Personeli (numri). Ai përbëhet nga të paktën shoferët dhe operatorët e kamionëve. Një kombinim i zakonshëm është një shofer për makinë dhe dy operatorëve gjatë grumbullimit të mbetjeve, por në zonat urbane me më shumë se 50.000 banorë mund të ketë edhe një punëtor ekstra (3), (e cila nuk është një praktikë e mirë). Operatorët nuk duhet ta ndjekin kamionin në 'landfill'. Në ekipe të mëdha ky program do të zvogëlonte numrin e operatorëve të nevojshëm për grumbullimin, duke reduktuar kostot.

Në modelin bashkëlidhur, numri i shoferëve dhe punëtorëve është llogaritur duke marrë parasysh numrin e turneve për një kamion dhe kufizimin ligjor të orëve të punës në ditë, dhe në javë. Në këtë

skemë, dy shoferët do të ndajnë të njëjtin kamion (një shofer mund ta përdorë atë paradite dhe tjetri pasdite).

Ekziston nevoja për infrastrukturë mbështetëse për personelin, gjë që përfshin uniforma, mjete për grumbullimin, pastruesit kimikë, etj. Këto janë pjesë e kostove administrative dhe janë përllogaritur në fund të skemës së llogaritjes.

b) Orët e punës (orë). Sipas kodit të punës të vendit tonë, një punonjës nuk duhet të punojë më shumë se 48 orë në javë, 8 orë prej të cilave konsiderohen si ato të paguara më shumë si orë shtesë dhe kjo jo më shumë se 12 orë në ditë, 4 prej të cilave konsiderohen si orë shtesë. Pra, për të llogaritur orët e punës për personelin menaxheri duhet të udhëhiqet nga nevoja e shërbimit të kamionit për të hequr mbetjet e gjeneruara. Orët jashtë orarit të punës duhet të shmangen kur është e mundur dhe duhet të vendoset një ekuilibër i mirë mes numrit të turneve, orëve për turn dhe orët e totale të punës për çdo staf. Nëse është e pashmangshme, duhet të llogariten kostot shtesë për orët shtesë, ose në qoftë se është vërtet e nevojshme të pajtohet në punë më shumë personel.

Në modelin e zhvilluar (referoju shtojcave), ne konsiderojmë maksimumin 8 orë në ditë dhe 40 orë në javë, në mënyrë që të shmangen orët shtesë.

Dita e punës së personelit përbëhet nga koha për grumbullimin, transportin, mirëmbajtjen (pastrimin e kamionit), raportimin (ditari) dhe takimet/trajnimet. Për llogaritjen e kostos duhet të kryhet një shpërndarje mes shërbimit të kamionit dhe mirëmbajtjes.

Në modelin bashkëlidhur, ne konsiderojmë maksimumin 7,3% të kohës së shpenzuar në punët e mirëmbajtjes dhe një shtesë 7,7% për ditët e pushimeve.

c) Pagat (lekë). Pagat janë llogaritur bazuar në kodin e punës, për të respektuar pagën minimale, pjesa tjetër është subjekt i llojit të punës dhe kapacitetit. Kombinuar me orët e punës, një pagë duhet të përfshijë detyra të tjera (shërbime të tjera të përbashkëta) në qoftë se shërbimet janë një herë në tre ditë ose më pak se 4 orë në ditë për menaxhimin e mbetjeve.

Tab. 5 - Përdorni tabelën më poshtë për të ndërtuar këtë bllok të sistemit të llogaritjes së kostos [TC 3]

Ref.	Zërat	Njësia matëse	Përdorimi i zërit	Komente
A	**Koha maksimale e punës**	*h/ditë*	Numër fiks	Kjo shifër është e rëndësishme për përcaktimin e numrit të personelit, duke shmangur orët e punës jashtë orarit. Kodi i punës duhet të merret parasysh këtu.
B	**Numri maksimal i ditëve të punës për javë**	*ditë/javë*	Numër fiks	Kjo shifër është e rëndësishme për përcaktimin e numrit të personelit, duke shmangur orët e punës jashtë orarit. Kodi i punës duhet të merret parasysh këtu.
C	**Koha maksimale e punës në javë**	*h/javë*	Numër fiks	Kjo shifër është e rëndësishme për përcaktimin e numrit të personelit, duke shmangur orët e punës jashtë orarit. Kodi i punës duhet të merret parasysh këtu.
D	**Mirëmbajtje [% e kohës së punës]**	*%*	Variabël	Kjo shifër është e rëndësishme për përcaktimin e numrit të personelit, duke shmangur orët e punës jashtë orarit.
E	**Pushime [% e kohës së punës]**	*%*	Variabël	Kjo shifër është e rëndësishme për përcaktimin e numrit të personelit, duke shmangur orët e punës jashtë orarit. E rëndësishme për aspektin ligjor dhe social.
F	**Sasia e shoferave**	*numër*	Variabël	Përllogaritur nga formula, duke konsideruar, kohën totale të harxhuar nga një shofer, limituar nga numri i turneve dhe kodi i punës për kohën maksimale të punës (A) dhe kohën e nevojshme për pushim.
G	**Paga për shofer** (të gjithë shoferët)	*lek/vit*	Variabël	Përllogaritur nga formula, duke konsideruar pagën gruto për çdo shofer * numrin e shoferëve në shërbim Paga e shoferave është subjekt ndryshimi nga administratorët
H	**Sasia e punonjësve / operatorëve**	*Numër*	Variabël	Përllogaritur nga formula, bazuar në numrin e shoferave dhe stadardit për përcaktimin e 2 operatorëve për çdo kamion, me një përjashtim për njësitë urbane me mbi 50.000 banorë, ku duhen 3 operatorë.
I	**Punonjësit shoqërojnë kamionin në fushë depozitimi**	*Tekst*	Variabël	Kjo është e rëndësishme për t'u përcaktuar me Po ose Jo, pasi shërben për rillogaritjen automatike të numrit të punonjësve dhe eficensën e kohës. Në një praktikë të mirë, operatorët nuk duhet të shkojnë në fushë depozitimi.

Ref.	Zërat	Njësia matëse	Përdorimi i zërit	Komente
J	**Paga për punonjës** (të gjithë punonjësit)	*Lek*	Variabël	Përllogaritur nga formula, duke konsideruar pagën bruto * numrin e punonjësve në shërbim Paga e punonjësve është subjekt ndryshimi nga administratorët
K	**Kosto totale për personelin**	*Lek*	Variabël	Përllogaritur nga formula, duke konsideruar totalin e shoferave + të punonjësve

1.4 Kostoja për depozitim 'landfill' (tarifa e depozitimit) [BLLOKU 4]

Qëllimi i këtij blloku është llogaritja dhe mbajtja e një llogarie të veçantë të kostos që lidhet me palën e tretë. Sipas legjislacionit për "mbetjet" çdo NJQV duhet t'i depozitojë mbetjet në një mënyrë të përshtatshme dhe të sigurt. Kostoja për depozitim mbetjesh është vendosur si tarifë hyrjeje dhe zakonisht paguhet për ton.

Kostot e depozitimit mund të jenë subjekt i ndryshimit, bazuar në sasinë e mbetjeve që shkon përditë në 'landfill' dhe në ndryshimin e shërbimeve që kryhen në të. Si pasojë duhet të nënshkruhet një marrëveshje e qartë, e cila do ta adresojë tarifën bazuar në një plan biznesi të përshtatshëm dhe të shtrirë në kohë.

Variablat në lidhje me kostot e depozitimit janë të thjeshta, bazuar në tarifën e hyrjes për ton, e cila është llogaritur si tarifë e përditshme dhe vjetore.

Tab. 6 - Përdorni tabelën më poshtë për të ndërtuar këtë bllok të sistemit të llogaritjes së kostos [TC 4]

Ref.	Zërat	Njësia matëse	Përdorimi i zërit	Komente
A	**Tarifa e depozitimit**	*Lek/ton*	Numër fiks	Tarifa e depozitimit përcaktohet nga operatori/autoriteti që menaxhon fushën e depozitimit dhe fiksohet në kontratë mes palëve
B	**Kostoja totale për depozitim**	*Lek/ton/ditë*	Variabël	Përllogaritet nga formula, duke konsideruar, sasinë e mbetjeve, e cila dërgohet në fushë deopzitimit çdo ditë * tarifën e depozitimit për ton
C	**Kosto totale për depozitim**	*Lek/vit*	Variabël	Përllogaritet nga formula, duke konsideruar sasinë totale të mbetjeve të gjeneruar në vit (e gjithë sasia dërgohet në fushë depozitimi) * **B**

1.5 Kostot e amortizimit të (ri-investimit) [BLLOKU 5]

Qëllimi i këtij blloku është llogaritja e kostove të nevojshme për ri-investim, në mënyrë që sistemi të mbahet në punë për një kohë të gjatë. Kjo është një çështje e qëndrueshmërisë të sistemit dhe do të sigurojë një sistem funksional.

Llogaritja bazohet në legjislacionin shqiptar për amortizimin e pajisjeve, e cila tregon një kohëzgjatje 5 vjeçare.

Variablat në këtë bllok janë të thjeshtë dhe lidhen direkt me koston vjetore për amortizimin për kamionë dhe kazanë. Kjo i shtohet sistemit si një përqindje për vitin, që praktikisht paraqet 20% të shumës totale të kostos për kamionë dhe kazanë në vit. Kjo nuk lidhet detyrimisht me amortizimin e vërtetë. Përdorimi i papërshtatshëm mund të shkurtojnë jetën e pajisjeve dhe për këtë arsye të ndikojë ndjeshëm në koston për mirëmbajtje, investime, dhe eficiencë të shërbimit (koha, karburanti).

Tab. 7 - Përdorni tabelën më poshtë për të ndërtuar këtë bllok të sistemit të llogaritjes së kostos [TC 5]

Ref.	Zërat	Njësia matëse	Përdorimi i zërit	Komente
A	**Amortizimi i kamionit, vite**	*Numër*	Numër fiks	Kjo shifër do të jetë 5 vite, duke konsideruar një mesatare vjetore prej 20%.
B	**Kostot e amortizimit të kamionit**	*Lek/vit*	Variabël	Përllogaritur nga formula, duke konsideruar numrin e kamionëve, koston për një kamion dhe shkallën e amortizimit në vit
C	**Amortizimi i kazanëve në vite**	*Numër*	Numër fiks	Kjo shifër do të jetë 5 vite, duke konsideruar një mesatare vjetore prej 20%. Por, kjo është subjekt verifikimi në bazë të përdorimit të kazanëve.
D	**Kostot e amortizimit të kazanëvee**	*Lek/vit*	Variabël	Përllogaritur nga formula, duke konsideruar numrin e kazanëve, çmimin e një kazani dhe shkallën e amortizimit në vit

1.6 Kostot administrative [BLLOKU 6]

Qëllimi i këtij blloku është llogaritja e kostove administrative të nevojshme për të drejtuar të gjithë sistemin, zhvilluar strategji dhe politika, për të siguruar eficiencë dhe efektivitet, ofruar trajnime dhe stërvitje, etj.

Kostot administrative mund të përfshijnë koston e nevojshme për rikuperimin e kostove dhe për fushatat e ndërgjegjësimit publik, e cila mund të shtohet më vete në sistem, ose të jetë pjesë e kostove të përgjithshme administrative. Ky vendim merret në bazë të kapaciteteve dhe nevojave të NJQV-së. Sistemi lejon përdorimin e dy qasjeve.

Përveç kësaj, duhen llogaritur të ardhurat neto, të cilat kërkohen për teknologji të reja, zgjerimin e shërbimit dhe çështje të tjera të paplanifikuara dhe të nevojshme.

Variablat këtu janë të thjeshta dhe shifra përcaktohet nga administratori vendor bazuar në kapacitetin financiar. Shifra është vendosur si një përqindje e kostove totale të 6 blloqeve të zhvilluara më sipër. Përvoja sugjeron se këto përqindje janë përkatësisht: 9% për kostot administrative dhe 4% të ardhura neto.

Tab. 8 - Përdorni tabelën më poshtë për të ndërtuar këtë bllok të sistemit të llogaritjes së kostos [TC 6]

Ref.	Zërat	Njësia matëse	Përdorimi i zërit	Komente
A	**Tarifa e administrimit** (total)	*%*	Numër fiks	Përllogaritur nga formula si **9%** e kostove totale operacionale
B	**Kostot administrative për kapjen e kostove**	*%*	Numër fiks	Përllogaritur nga formula si **xx%** e kostove totale operacionale
C	**Kostot administrative për fushtat e ndërgjegjësimit**	*%*	Numër fiks	Përllogaritur nga formula si **xx%** e kostove totale operacionale
D	**Kostot administartive** *(totale)*	*Lek/vit*	Variabël	Përllogaritur nga formula (**%A+B+C * total operacione)**.
E	**Të ardhura neto**	*Lek/vit*	Variabël	Përllogaritur nga formula (**4% * total operacione)**

Në fund të këtij blloku, ne mund të shtojmë dy rreshta të tjerë poshtë shumave totale të skemës.

1.7 Shumat e përgjithshme [BLLOKU 7]

Ky bllok mundëson një paraqitje përfundimtare të kostove totale. Këtu dallohen qartë kostot në lidhje investimet në vitin e parë dhe faturën totale të menaxhimit të mbetjeve për vit.

Tab. 9 - Përdorni tabelën më poshtë për të ndërtuar këtë bllok të sistemit të llogaritjes së kostos [TC 7]

Ref.	Zërat	Njësia matëse	Përdorimi i zërit	Komente
A	**Kosto totale investimi (1 herë)**	*Lek*	Variabël	Kjo vlerë është e barabartë me shumë e nevojshme për blerjen e kamionëve dhe kazanëve.
B	**Kostot totale vjetore**	*Lek*	Variabël	Kjo përllogaritet si shumë e kostove operacionale + të depozitimit + administrative dhe fitim neto + amortizim. Kjo shumë përcakton buxhetin vjetor për menaxhimin e mbetjeve
C	**Kostot totale operacionale dhe investimet për vitin e parë**	*Lek*	Variabël	Përllogaritur nga formula si shumë (**A + B**) dhe përfaqëson kapacitetin e nevojshëm financiar për të nisur shërbimin e menaxhimit të mbetjeve.

Duke renditur të gjitha tabelat e mësipërme dhe duke i lidhur mes tyre, ne kemi zhvilluar një sistem të plotë të llogaritjes së kostos. Ky sistem do të informojë menaxherin mbi nevojat për investime, personel, operacione, amortizimin e mjeteve dhe kosto të tjera, në mënyrë që të jetë në gjendje të paraqesë vlerësimin e kostos në nivelin e duhur tek kryetarit të bashkisë dhe këshillit të njësisë.

Për ta mbajtur sistemin të përditësuar variablat e fiksuar janë mbajtur në një faqe më vete, të tilla si distanca rrugore në një tabelë, çmimet për pajisjet, kostot e karburantit, pagat e personelit, etj., duke vepruar kështu, menaxheri mund të ndryshojë shifrat në këto tabela dhe sistemi, duke qenë i lidhur me këto tabela do të përditësojë të gjitha shifrat dhe ofrojë rezultate të menjëhershme.

Këtu ne ofrojmë një shembull se si të gjitha këto tabela mund të formojnë një sistem të plotë, të mbyllur dhe funksional.

1.8 Modeli – Sistemi i llogaritjes së kostos për menaxhimin e mbetjeve

PËRLLOGARITJA E KOSTOS		
MODEL		

Të dhënat bazë		
Emri i NJQV	Shembull	
Frekuenca e grumbullimit (nr. e mbledhjeve)	7	*2 opsione: 2 ose 7*
Kategoria (Rurale, Urbane)	Urban	
Popullsia (rezidente/sipas census)	113,350	
% e popullsisë që përjashtohen (të regjistruar, por jetojnë jashtë)	0%	
Popullsia shërbyer (merr/konsiderohet për shërbimin)	113,350	
Rrugët (distanca nga Landfill një kah) [km]	16.0	
Rrugët (distanca e përshkuar gjatë grumbullimit për një turn për një kamion) [km]	15.0	
Mbetjet e gjeneruara për person [kg/ban]	1.0	
Totali i mbetjeve të gjeneruara [t/dit]	113.4	
Totali i mbetjeve të gjeneruara ndërmjet dy grumbullimeve [t] sipas frekuencës z	113.4	
Totali i mbetjeve të gjeneruar [t/vit]	41373	

Kamionë		
Hipotezat : grumbullimi në të gjithë territorin e NJQVsë, çdo ditë grumbullimi		
Tipi i kamionit (tipi: 10t urban - 5t rural) [t]	10	
Faktori i mbushjes së kamionit [%]	0.85	
Kapaciteti mbushës i kamionit (85% kapacitet mbushës) [t]	8.5	
Kufiri për numrin e turneve dhe kamionëve që nevojiten (duke marrë në konsideratë faktin e mbushjes së kamionëve plotësisht, për të evituar blerjen e një tjetri) [t]	*1.50*	
Numri i turneve për kamion në ditë [turne/ditë]	2	*1 ose 2 turne*
Numri i kamionëve të nevojshëm [total]	7.0	

Kazanë		
Hipoteza : grumbullim në të gjithë territorin, grumbullim çdo ditë		
Pesha e mbetjeve në një kazan [t]	0.10	
Numri i kazanëve (titpi 1.1 m3 - 85% kapacitet mbushës)	1102	

Kostot operative (grumbullim, transport, mirëmbajtje, personel)		
Ditë në punë/VIT (nëse më pak se 2ton/ditë, grumbullimi 2herë/javë)	365	
Kostot e karburantit [LEK/l]	190.0	

Kostot e mirëmbajtjes		
Sigurimi i kamionit + taksat [LEK/kamion/vit]	150,000 Lek	*1,079.14 €*
Vaj + filtra [LEK/kamion/vit]	90,000 Lek	*647.48 €*
Goma [LEK/kamion/vit]	160,000 Lek	*1,151.08 €*
Mirëmbajtja mekanike [LEK/kamion/vit]	200,000 Lek	*1,438.85 €*
Parkim [LEK/kamion/vit]	200,000 Lek	*1,438.85 €*
Kostot totale të mirëmbajtjes [LEK/vit]	5,600,000 Lek	*40,287.77 €*
Kostot e grumbullimit dhe të transportit		
Kostot e grumbullimit		
4. Kostot e depozitimit (tarifa e hyrjes) ose trajtim tjetër apo aktivitete të riciklimit
5. (Ri-investo) Shpenzimet e amortizimit
6. Kostot administrative dhe informative

Përveç kësaj, shuma totale e tarifës duhet të marrë në konsideratë përqindjen e pambuluar (shkallën e mospagimit). Ajo duhet të jetë pjesë e vendimit të NJQV-së për të përcaktuar se cila pjesë e kostos duhet të jetë e mbuluar nga të ardhurat tarifore dhe cila pjesë do të mbulohet nga të ardhurat e tjera të njësisë së qeverisjes vendore. Në teori, shuma e vërtetë e parave të mbledhura në vit duhet të mbulojë koston reale vjetore të shpenzuar për menaxhimin e mbetjeve, me qëllim sigurimin e qëndrueshmërisë së shërbimit. Kjo ilustrohet nga grafiku në vijim (2).

Në të gjitha rastet, rekomandohet të zgjidhet një model sa më i thjeshtë të jetë e mundur. Tundimi për të ndërlikuar modelin, duke u përpjekur për t'i dhënë më shumë baza barazie, mund të rrisë koston e administrimit të modelit/sistemit, por në anën tjetër duhet të ruhet balanca, në mënyrë që të mos zvogëlohet ndjeshëm niveli i pabarazisë.

Grafiku 2 – Dinamika e mbulimit të kostos



3. Paraqitja e modeleve

Ky dokument paraqet tre modele të ndryshme të përllogaritjes dhe menaxhimit të tarifës, të cilat janë konsoliduar nga pilotimi në kushtet e NJQV-ve të ndryshme në Shqipëri, në kuadër të programit dldp.

Në përmbledhje, tre modele janë si më poshtë:

Modeli 1	**BAZUAR NË NUMRIN E POPULLSISË / PUNONJËSVE**
Modeli 2	**BAZUAR NË SIPËRFAQEN E PRONËS**
Modeli 3	**PROGRESIV**

3.1 Modeli i bazuar në numrin e popullsisë / punonjësve

3.1.1 Përqasja që sjell modeli

Ky model bazohet në një qasje shumë të thjeshtë. Ai supozon se gjenerimi i mbetjeve është pak a shumë në proporcion me numrin e personave (banorë ose punëmarrës) në territorin e NJQV-së dhe merr parasysh se këto të dhëna janë lehtësisht të grumbullueshme dhe të menaxhueshme.

Në thelb modeli është i bazuar në numrin e popullsisë ose të të punësuarve, përkatësisht në një familje, në një biznes apo institucion. Modeli ka për qëllim të mbulojë plotësisht shpenzimet e menaxhimit të mbetjeve të ngurta .

Tarifa është vendosur për tre kategoritë e gjeneruesve/klientëve, duke respektuar një shkallë shpërndarjeje të zgjedhur nga vetë NJQV-ja. Shpërndarja në mes të kategorive të ndryshme varet nga kushtet lokale dhe kërkon një vendim politik. Shembulli i paraqitur në kapitullin 2 të këtij manuali mund të përdoret për të mbështetur vendimin.

Modeli ofron mundësinë për përjashtimin e familjeve nën skemën e ndihmës sociale. Përdorimi i këtij parametri zbritjeje përsëri është një vendim politik vendor, me ligj është këshilli lokal i cili vendos për një përjashtim të plotë, tarifa të reduktuara ose përfshirjen e këtij grupi.

Modeli konsideron një normë të mospagesës për çdo kategori. Në modelin e dhënë, shkalla e mospagesës do të rrisë tarifën për paguesit e rregullt. Vendimi për të rishpërndarë shpenzimet për paguesit e rregullt është përsëri një vendim politik. NJQV-ja mund të përdorë subvencione ose fonde të tjera për të mbuluar këtë hendek për të shmangur shpenzimet shtesë, të padrejta për paguesit e rregullt.

Modeli i respekton parimet kryesore tarifore në nivelin e mëposhtëm:

Parimet	+	-
Ndotësi paguan:	Çdo kategori e gjenerimit të mbetjeve është konsideruar në këtë model dhe është vlerësuar në bazë të shkallës së gjenerimit të mbetjeve.	Modeli ka konsideratë të kufizuar për nivelin e vërtetë të gjenerimit të mbetjeve të llojeve të ndryshme të zonave, bizneseve apo institucioneve. Në veçanti ai nuk merr parasysh dallimin në gjenerimin e mbetjeve ndërmjet një zone apo shtëpie të pasur dhe një zone apo shtëpie të varfër.
Transparenca	Modeli siguron një tarifë të qartë për secilën kategori dhe është efikas për familjet pasi konsideron numrin e pjesëtarëve të familjes për caktimin e tarifave.	Klienti faturohet bazuar në një kriter të vetëm, pavarësisht faktorëve të tjerë.
Eficenca menaxheriale	Modeli është i lehtë për t'u zhvilluar dhe për t'u mirëmbajtur: të dhënat e banorëve ose të të punësuarve ekzistojnë në NJQV.	Të dhënat për numrin e banorëve njihen si të paplota dhe shpesh të pasakta në NJQV. Kjo është veçanërisht e vërtetë në zonat turistike.

3.1.2 Të dhënat e nevojshme

Për zhvillimin e këtij modeli të dhënat e mëposhtme nga burimet përkatëse janë të nevojshme:

Të dhënat	Burimi i mundshëm
Numri i familjeve	Censusi; Klientët e Ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizimeve; Zyra e Ndihmës Ekonomike
Numri i pjesëtarëve të familjes	Censusi; Klientët e Ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizimeve
Numri i bizneseve	Zyra e taksave
Numri i punonjësve për çdo biznes	Zyra e tatimeve
Numri i institucioneve	Zyra e taksave
Numri i punonjësve/përdoruesve të regjistruar për institucion	Zyra e tatimeve

3.1.3 Prezantim i detajuar i modelit (modeli i zhvilluar plotësisht në excel)

Tabela 1 – Modeli 1 i shpjeguar (përdorimi i tabelës – Menaxhimi i të dhënave)

Të dhënat bazë	Vlera	Njësia	[Vlera] e shpjeguar
Buxheti i shpenzuar			
Buxheti për menaxhimin e mbetjeve, përfshirë amortizimin	Numër	Lekë/vit	Vendos këtu koston totale të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve për një vit.
Klientët			
Familjet	Numër	Familje	Numri total i familjeve sipas Censusit më të fundit

Familjet – numri total i pjesëtarëve të familjeve / banorët e NJQV-së	Numër	Banorë	Numri total i banorëve të NJQV-së. Të dhënat janë të rëndësishme për përllogaritjen e tarifës për çdo familje.
Publike / institucione	Numër	Institu-cione	Numri total i institucioneve publike apo private në territorin e NJQV-së.
Publike / institucione, numri i punonjësve	Numër	Punonjës	Numri total i punonjësve të regjistruar ose që janë përdorues zyrtarë të institucionit (p.sh. për një shkollë, numrin total të mësuesve, administratës dhe nxënësve të regjistruar)
Biznesi / industria – numri total[1]	Numër	Biznese	Numri total i bizneseve pavarësisht kategorisë së tyre
Biznesi / industria – numri total i punonjësve	Numër	Punonjës	Numri total i punonjësve të regjistruar në bizneset e sipërshënuara.
Shpërndarja e kostos ndërmjet kategorive/klientëve[2]			
Familjare	Përqindje	%	Vendos përqindjen totale të tarifës, e cila t'i faturohet kategorisë familjare. Mund t'i referoheni shembullit të treguar më sipër në këtë manual.
	Numër	Lekë/vit	Kjo fushë përllogaritet nga formula si përqindje e kostos që i përket kësaj kategorie. {kosto totale * % e kësaj kategorie}
Publike/institucione	Përqindje	%	E njëjta logjikë si për familjet
	Numër	Lekë/vit	Formulë: E njëjta logjikë si për familjet
Biznes/industri	Përqindje	%	E njëjta logjikë si për familjet

	Numër	Lekë/vit	Formulë: E njëjta logjikë si për familjet
Kontroll i shpërndarjes	Përqindje	% ok	Shuma totale e 3 kategorive. Duhet të jetë 100%.
Proporcioni i klientëve në secilën kategori[3]			
Familjet - % e familjeve të përjashtuara për arsye sociale	Përqindje	%	Vendos këtu përqindjen e familjeve të cilat janë në listën e ndihmës sociale. Vlera do të rregullohet bazuar në vendimet që merr këshilli i njësisë, duke përdorur logjikën e përmendur më lart.
Familjet - % e mospagesës	Përqindje	%	Vendos këtu përqindjen e familjeve të cilat nuk e paguajnë tarifën.
Institucionet - % e mospagesës	Përqindje	%	Vendos këtu përqindjen e institucioneve të cilat nuk e paguajnë tarifën.
Bizneset - % e mospagesës	Përqindje	%	Vendos këtu përqindjen e bizneseve, të cilat nuk e paguajnë tarifën.
Familjare – nr. total i paguesve (njësi paguese)	Numër	Familje	Llogaritet nga formula, duke marrë në konsideratë përqindjen e shpërndarjes, zbritjen për arsye sociale dhe shkallën totale të mospagimit. Rezultati është numri total i familjeve që pritet të paguajnë tarifën.
	Numër	Banorë	Llogaritet nga formula, duke marrë në konsideratë përqindjen e shpërndarjes, zbritjen për arsye sociale dhe shkallën totale të mospagimit. Rezultati është numri total i banorëve që pritet të paguajnë tarifën.

Publike/institucione, nr. total i njësive paguese	Numër	Institu-cione	Formulë: e njëjta logjikë si për familjet
	Numër	Punonjës/ përdorues të institu-cionit	Formulë: e njëjta logjikë si për familjet
Biznese/industri, nr. i njësive paguese	Numër	Biznese	Formulë: e njëjta logjikë si për familjet
	Numër	Punonjës	Formulë: e njëjta logjikë si për familjet
Përllogaritja e tarifës bazë për secilën kategori			
Frekuenca e tarifimit	Numër	Fatura/vit	Bazuar në vendimin e NJQV-së, për të prerë faturë një herë në 6 muaj apo në vit. Vendos këtu numri e herëve në vit për të cilën pritet fatura.
Familjare	Numër	Lekë/ banorë/ faturë	Përllogaritet nga formula. Jep tarifën referencë që paguhet nga kjo kategori.
Institucione	Numër	Lekë/ punonj./ faturë	Përllogaritet nga formula. Jep tarifën referencë që paguhet nga kjo kategori
Biznese	Numër	Lekë/ punonj./ faturë	Përllogaritet nga formula. Jep tarifën referencë që paguhet nga kjo kategori

1) Vetëm bizneset dhe industritë që prodhojnë mbetje të ngjashme me ato komunale dhe që mblidhen nga shërbimi publik. Ajo përjashton spitalet, kompanitë e ndërtimit dhe cilëndo njësi prodhimi të mbetjeve të rrezikshme apo të veçanta, të cilat do të mblidhen nga kompani të tjera publike apo private.
2) Mund të bazohet në gjenerimin proporcional të mbetjeve, nëse dihet, ose në bazë të shpërndarjes së individëve.
3) Si një qasje e parë, ne mund të konsiderojmë se numri i banorëve ose i të punësuarve është në përpjestim me numrin e familjeve, institucioneve apo të biznesit. Ky numër mund të precizohet nëse ekzistojnë të dhëna më të detajuara.

3.1.4 Përllogaritja e tarifës individuale

Shto aq rreshta (kujdes, mos e prishni formulën e rreshtit) sa familje, institucione dhe biznese janë të regjistruara në territorin e njësisë vendore. Më pas nën secilën kategori shtoni listat përkatëse të familjeve, institucioneve dhe bizneseve, duke shtuar për secilin prej tyre numrin e pjesëtarëve të familjes apo numrin e të punësuarve. Duke bërë kështu, formula do të punojë vetë për të llogaritur tarifën për secilën familje, institucion dhe biznes.

Tabela 2 – Modeli 1 i shpjeguar (Tabela e përllogaritjes së tarifës – e lidhur me tabelën më lart) (Shembull)

Lista e klientëve	Njësia	Tarifa për faturë	
	[banorë] / [punonjës]	[lekë/periudhë] {tarifë referencë * numrin e pjesëtarëve të familjes/punonjësve}	
Familje (kryefamiljari)			
Z. xyz	4	718	lekë/faturë
Znj. stu	2	359	lekë/faturë
…			
Institucion			
Institucioni i1	20	2857	lekë/faturë
Institucioni i 2	80	11429	lekë/faturë
…			
Biznes			
Biznesi B1	3	469	lekë/faturë
Biznesi B2	6	938	lekë/faturë
…			

3.2 Modeli i bazuar në sipërfaqen e pronës

3.2.1 Përqasja që sjell modeli

Ky model paraqet qasjen e njëjtë si për modelin e parë të kufizuar në një faktor. Ai supozon se gjenerimi i mbetjeve mund të jetë në

proporcion me sipërfaqen e ndërtuar të pronës, të dhënat për të cilën mund të mblidhen lehtësisht.

Në thelb modeli është i bazuar në sipërfaqen e pronës për kategoritë familjarë, biznes dhe institucione. Ai, gjithashtu, ka për qëllim të mbulojë plotësisht shpenzimet e menaxhimit të mbetjeve të ngurta.

Modeli i konverton të gjitha të dhënat në metra katror të pronës truall, për të llogaritur tarifën për secilën familje, institucion dhe biznes.

Logjika e njëjtë e shpërndarjes së peshës së pagesës për secilën kategori, e shpjeguar për modelin e parë, përdoret në këtë model.

Modeli i respekton parimet kryesore tarifore në nivelin e mëposhtëm:

Parimet	+	-
Ndotësi paguan:	Çdo kategori e gjenerimit të mbetjeve merret në konsideratë në këtë model dhe peshohet në bazë të shkallës së gjenerimit. Modeli konsideron se gjenerimi i mbetjeve është proporcional me sipërfaqen e shtëpive, e cila mund të përkojë me nivelin e pasurisë së pronarit.	Modeli nuk e konsideron përdorimin e vërtetë të ndërtesës. Në kohë të ndryshme, një ndërtesë mund të përdoret nga disa familje ose një person i vetëm, por pronari do të duhet të paguajë të njëjtën tarifë. Në mënyrë të ngjashme, disa biznese mund të gjenerojnë një sasi të ndryshme të mbetjeve në një sipërfaqe të vogël të pronës krahasuar me një biznes në një ndërtesë shumë të madhe.
Transparenca	Modeli siguron shpërndarjen e tarifave për çdo kategori. Tarifa është e qartë dhe e qëndrueshme në kohë.	Klienti faturohet bazuar në një kriter të vetëm, pavarësisht faktorëve të tjerë të gjenerimit të mbetjeve.
Eficenca menaxheriale	Modeli është i lehtë për t'u zhvilluar dhe përditësuar. Të dhënat janë zakonisht në disponueshme. Kriteri i sipërfaqes së pronës është më i qëndrueshëm dhe i lehtë për t'u kontrolluar se sa numri i banorëve.	Të dhënat mbi pronën e familjes mund të jenë të vështira për t'u mbledhur, për shkak të procesit të regjistrimit fillestar dhe përditësimin të të dhënave.

3.2.2 Të dhënat e nevojshme

Për zhvillimin e këtij modeli të dhënat e mëposhtme nga burimet përkatëse janë të nevojshme:

Të dhënat	Burimi i mundshëm
Numri i familjeve	Censusi; Klientët e ndërmarrjes së ujësjellës-kanalizimeve; Zyra e ndihmës ekonomike
Sipërfaqja e pronës për çdo familje	Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
Numri i bizneseve	Zyra e taksave
Sipërfaqja e pronës për çdo biznes	Zyra e taksave; Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
Numri i institucioneve	Zyra e taksave
Numri i punonjsëve/ përdorueseve të institucionit	Zyra e taksave; Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

3.2.3 Prezantim i detajuar i modelit (modeli i zhvilluar plotësisht në excel, bashkalidhur)

Tabela 3 – Modeli 2 i shpjeguar (përdorimi i tabelës – Menaxhimi i të dhënave)

Të dhënat bazë	Vlera	Njësia	[Vlera] e shpjeguar
Buxheti i shpenzuar			
Buxheti për menaxhimin e mbetjeve, përfshi amortizimin	Numër	Lek/vit	Vendos këtu koston totale të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve për një vit.
Klientët			
Familjet	Numër	Familje	Numri total i familjeve sipas censusit më të fundit

Familjet – sipërfaqja totale e pronave	Numër	m2	Sipërfaqja totale e pronës familjare (truall) në territorin e NJQV-së
Institucione	Numër	Institu-cione	Numri total i institutusioneve publike apo private në territorin e NJQV-së.
Institucione – sipërfaqja totale e pronave	Numër	m2	Sipërfaqja totale e pronës publike (truall) në territorin e NJQV-së
	Numër		
Biznese	Numër	Biznese	Numri total i bizneseve pavarësisht kategorisë së tyre
Biznese – sipërfaqja totale e pronave	Numër	m2	Sipërfaqja totale e pronës private/biznes (truall) në territorin e NJQV-së
Proporcioni i klientëve në secilën kategori[1]			
Familjare	Përqindje	%	Vendos përqindjen totale të tarifës, e cila t'i faturohet kategorisë familjare. Mund ti referoheni shembullit të treguar mësipër në këtë manual.
	Numër	lek/vit	Kjo fushë përllogaritet nga formula si përqindje e kostos që i përket kësaj kategorie. {kosto totale * % e kësaj kategorie}
Publike/ institucione	Përqindje	%	E njëjta llogjikë si për familjet
	Numër	lek/vit	Formulë: E njëjta llogjikë si për familjet
Biznes/industry	Përqindje	%	E njëjta llogjikë si për familjet
	Numër	lek/vit	Formulë: E njëjta llogjikë si për familjet
Kontroll i shpërndarjes	Përqindje	% ok	Shuma totale e 3 kategorive. Duhet të jetë 100%.

Proporcioni i klientëve në secilën kategori			
Familjet - % e familjeve të përjashtuara për asrye sociale	Përqindje	%	Vendos këtu përqindjen e familjeve të cilat janë në listën e ndihmës sociale. Vlera do të rregullohet bazuar në vendimet që merrr këshilli i njësisë, duke përdorur llogjikën e përmendur më lart.
Familjet - % e mospagesës	Përqindje	%	Vendos këtu përqindjen e familjeve, të cilat nuk e paguajnë tarifën.
Institucionet- % e mospagesës	Përqindje	%	Vendos këtu përqindjen e institucioneve, të cilat nuk e paguajnë tarifën.
Biznese- % e mospagesës	Përqindje	%	Vendos këtu përqindjen e bizneseve, të cilat nuk e paguajnë tarifën.
Familjare – no. total i paguesve (njësi paguese)	Numër	familje	Llogaritet nga formula, duke marrë në konsideratë përqindjen e shpërndarjes, zbritjen për arsye sociale dhe shkallën totale të mospagimit. Rezultati është numri total i familjeve që pritet të paguajnë tarifën.
	Numër	m2	Llogaritet nga formula, duke marrë në konsideratë përqindjen e shpërndarjes, zbritjen për arsye sociale dhe shkallën totale të mospagimit. Rezultati është numri total i m2 që llogariten në pagesën e tarifës.
Publike/ institucione, nr. total i njësive paguese	Numër	Institu-cione	Formulë: e njëjta llogjikë si për familjet

	Numër	m2	Formulë: e njëjta llogjikë si për familjet
Biznese/industri, nr. i njësive paguese	Numër	Biznese	Formulë: e njëjta llogjikë si për familjet
	Numër	m2	Formulë: e njëjta llogjikë si për familjet
Përllogaritja e tarifës bazë për secilën kategori			
Frekuenca e tarifimit	Numër	fatura/vit	Bazuar në vendimin e NJQV-së, për të prerë faturë një herë në 6 muaj apo në vit. Vendos këtu numri e herëve në vit për të cilën prehet faturë.
Familjare	Numër	Lek/m2/ faturë	Përllogaritet nga formula. Jep tarifën referencë që paguhet nga kjo kategori.
Institucione	Numër	Lek/m2/ faturë	Përllogaritet nga formula. Jep tarifën referencë që paguhet nga kjo kategori
Biznese	Numër	Lek/m2/ faturë	Përllogaritet nga formula. Jep tarifën referencë që paguhet nga kjo kategori

1) Mund të bazohet në gjenerimin proporcional të mbetjeve, nëse dihet, ose në bazë të shpërndarjes së individëve

3.2.4 Përllogaritja e tarifës individuale

Shto aq rreshta (kujdes, mos e prishni formulën e rreshtit) sa familje, institucione dhe biznese janë të regjistruara në territorin e njësisë vendore. Më pas nën secilën kategori shtoni listat përkatëse të familjeve, institucioneve dhe bizneseve, duke shtuar detajuar për secilin prej tyre sipërfaqen përkatëse truall. Duke bërë kështu, formula do të punojë vetë për të llogaritur tarifën për secilën familje, institucion dhe të biznes.

Tabela 4 – Modeli 2 i shpjeguar (Tabela e përllogaritjes së tarifës – e lidhur me tabelën më lart) (Shembull)

Lista e klientëve	Njësia	Tarifa për faturë	
	[m2]	[lek/periudhë] {tarifë referencë * sipërfaqen e truallit të familjes/inst./biz.}	
Familje (kryefamiljari)			
Z. xyz	4	718	lekë/faturë
Znj. stu	2	359	lekë/faturë
…			
Institucion			
Institucioni i1	20	2857	lekë/faturë
Institucioni i 2	80	11429	lekë/faturë
…			
Biznes			
Biznesi B1	3	469	lekë/faturë
Biznesi B2	6	938	lekë/faturë
…			

3.3 Modeli progresiv

3.3.1 Përqasja që sjell modeli

Ky model përfaqëson një qasje më gjithëpërfshirëse në menaxhimin e tarifave. Ajo përfshin më shumë tregues të gjenerimit të mbetjeve dhe hap mundësitë e krijimit të stimujve financiare për praktikat e mira. Megjithatë, duhet patur parasysh se ky model ka nevojë për shumë të dhëna dhe përpunim të tyre.

Modeli është zhvilluar dhe konsoliduar në bazë të përvojës së modelit për menaxhimin e tarifave për furnizimin me ujë, duke përdorur faktorin e faturimit si kriter vendosje të tarifës (shih 4.3.3), e cila në vetvete llogaritet nga një përzierje e disa treguesve. Modeli është finalizuar në bazë të rezultateve të pilotimin në disa NJQV në vend gjatë vitit 2013[1].

Tarifa përcaktohet për tre kategoritë e gjeneruesve/klientëve, duke mos përcaktuar asnjë kriter paraprak shpërndarje të barrës së kostos. Në këtë rast shpërndarja ndërmjet kategorive është e rregulluar vetë në bazë në multi-kritereve të vendosura për secilin grup klientësh. Këto kritere, të përshkruara qartë më poshtë, janë: a) Prania e oborrit; b) Madhësia; c) Largësia nga qendra e qytetit/komunës deri tek gjeneruesi d) Masat për prodhuesit e mëdhenj apo të veçantë; e) Masat reduktuese (nxitëse).

Në thelb, në këtë model, çdo klient duhet të paguajë tarifën e referencës (faktori i faturimit = 1), e cila rritet në bazë të faktorëve të tjerë që shpjegohen më vonë në këtë kapitull.

Modeli ofron mundësinë për përjashtimin e familjeve nën skemën e ndihmës sociale. Si shpjegohet dhe mësipër, përdorimi i këtij parametri zbritje është një vendim politik vendor, me ligj është këshilli lokal, i cili vendos për një përjashtim të plotë, gjysëm tarifor ose përfshirjen e këtij grupi në tarifa.

Modeli konsideron normën totale të mospagimit, por në përqindje të akumuluar, duke marrë parasysh shumën e parave të pa mbledhura nga viti i kaluar si një numër total/përqindje. Njësoj si më sipër, përqindja e mospagesës rrit tarifën për paguesit e rregullt. Vendimi për të rishpërndarë shpenzimet për paguesit e rregullt është një vendim politik. NJQV mund të përdorë subvencione ose fonde të

1) NJQV-të e përfshira në këtë pilotim janë Shkodra, Lezha, Dajçi i Bunës dhe Puka

tjera për të mbuluar këtë hendek dhe për të shmangur shpenzimet shtesë, të padrejta për paguesit e rregullt.

Përdorimi i të gjithë treguesve dhe kritereve është shpjeguar më poshtë.

Modeli i respekton parimet kryesore tarifore në nivelin e mëposhtëm:

Parimet	+	-
Ndotësi paguan:	Llogaritje më e detajuar e tarifave e bazuar në disa tregues, e cila avancon kuptimin për nivelin e ndikimit të çdo gjeneruesi. Modeli mundëson stimulimin për menaxhimin me mençuri të mbetjeve, duke futur faktorin reduktim tarifor.	-
Transparenca	Modeli siguron transparencë të plotë për përdoruesit, duke prodhuar një faturë të detajuar. Disa parametra përdoren për të dalluar çdo klient nga tjetri. Sistemi tarifor mund të përdoret për qëllime informative në faturë.	-
Eficenca menaxheriale	Mundëson një infromacion të plotë për çdo klient.	Kërkon shumë të dhëna paraprake dhe një përditësim të shpeshtë të disa prej tyre. Sistemit duhet të përdoret vetëm nga profesionistë të trajnuar.

3.3.2 Të dhënat e nevojshme

Për zhvillimin e këtij modeli të dhënat e mëposhtme nga burimet përkatëse janë të nevojshme:

Të dhënat	Burimi i mundshëm	Arsyeja e përdorimit
Numri i familjeve	*Censusi; Klientët e ndërmarrjes së ujësjellës-kanalizimeve; Zyra e ndihmës ekonomike*	*Të listohen në sistem si klientë zyrtarë*
Numri i pjesëtarëve të çdo familje	*Censusi; Klientët e ndërmarrjes së ujësjellës-kanalizimeve*	*Të përdoren për nën faktorin "madhësi", ku për familjet është numri i pjesëtarëve të familjes.*
Sipërfaqja e pronës për çdo familje	*Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme*	*Të përdoren në faktorin "oborr". Sipërfaqja e oborrit është një faktor që përdoret për secilën pronë truall, si faktor përllogaritje të tarifës.*
Numri i bizneseve	*Zyra e taksave*	*Të listohen në sistem si klientë zyrtarë*
Sipërfaqja e pronës për çdo biznes	*Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme*	*Të përdoren për nën faktorin 'madhësi", e cila për biznesin është m2.*
Kategoritë e biznesit dhe veprimtaria e tyre	*Zyra e taksave*	*Të përdoret për nën faktorin "madhësi", i cili është i kombinuar me faktorin e sipërfaqes duke gjeneruar së bashku një factor të vetëm të madhësisë për këtë kategori.*
Numri i institucioneve	*Zyra e taksave; Zyra e Arsimit*	*Të listohen në sistem si klientë zyrtarë*
Numri i punonjësve/ përdoruesve të çdo institucioni	*Zyra e tatimeve*	*Të përdoren për nën faktorin 'madhësi", e cila për institucionet është numri i punonjësve/ përdoruesve të regjistruar.*
Adresa për secilin klient (familje, institucion, biznes)	*Zyra e Urbanistikës në NJQV; Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme*	*Të përdoren për nën faktorin "distance nga qendra" në km.*

3.3.3 Prezantim i detajuar i modelit (sipas modeli të zhvilluar plotësisht në excel)

Ky model është i bazuar në përdorimin e faktorit të faturimit dhe koeficientëve për llogaritjen e tarifës për çdo klient. Si model tarifor është shumë inovativ dhe koeficientët e paraqitura këtu janë propozuar në bazë të vlerësimit të përgjithshëm profesional, por jo në ligj, rregullore ose shembuj.

Modeli përdor dy fletë excel (sheets) për zhvillimin e bazës së të dhënave:

1. Menaxhimi i të dhënave (Sheet 1) ka tre tabela kryesore, si ne vijim: a) Përcaktimi i kategorive; b) Llogaritja e faktorit të madhësisë, dhe c) Atribuimi i faktorit të faturimit.
2. Llogaritja e tarifave (Sheet 2) ka dy tabela, si në vijim: a) Llogaritja e tarifës referencë; dhe, b) Llogaritja e tarifës për çdo klient.

3.3.3.1 Fleta 1 - Menaxhimi i të dhënave

Tabela 5: Hapi 1 – Përcaktimi i kategorive dhe parametrave që do të influencojnë tarifën për çdo klient (="malus")
Kujdes: Ky është një sistem me bazë formulash, nuk duhet të ndryshohen vlerat apo të hidhen të dhëna në këtë tabelë.

Faktorët e përllogaritjes së tarifës													
Kategoria		Oborr		Madhësia**			Distanca nga qendra			Prodhues "i madh" apo i veçantë*		Masat reduktuese (incentiva) (përdoret në rastet e aprovuara, që kualifikohen për këtë masë)	
		Jo	Po	Vogël	Mesëm	Madh	0-5 km	5-10 km	>10km	Jo	Po	Jo	Po
				1-3 pers.	4-6 pers.	>6 pers.							
Familje		+ 0%	+ 100%	0%	+ 40%	+ 80%	0%	+ 20%	+ 40%	+ 0%	+ 100%	-0%	-20%
				1-15 puonj.	16-30 punonj.	> 30 punonj., për çdo punonj. shtesë.							
In-stitucion		+ 20%	+ 100%	20%	+ 60%	+ 2.7%	+ 20%	+ 40%	+ 60%	+ 20%	+ 100%	-0%	-20%
				sip.e biznesit : 0-50 m2	sip. e biznesit : 50-100 m2	> 100 m2, për çdo 50 m2 shtesë							
Biznese kat. 1	prodh. i ulët	+ 20%	+ 100%	+ 20%	+ 40%	+ 20%	+ 20%	+ 40%	+ 60%	+ 20%	+ 100%	-0%	-20%
Biznese kat. 2	prodh. i mesëm	+ 20%	+ 100%	+ 40%	+ 60%	+ 20%	+ 20%	+ 40%	+ 60%	+ 20%	+ 100%	-0%	-20%
Biznese kat. 3	prodh. i lartë	+ 20%	+ 100%	+ 60%	+ 80%	+ 20%	+ 20%	+ 40%	+ 60%	+ 20%	+ 100%	-0%	-20%

** Aplikohet mbi bizneset dhe institucionet që prodhojnë mbetje të ngjashme me ato urbane (përjashtuar spitalet, inertet apo mbetjet industriale)*
***Nuk mund të kalojë + 900% (Tavani 345 punonjës ose 2250 m2)*

3.3.3.2 Sheet 1 – Përllogaritja e faktorit të madhësisë

Tabela 6: Hapi 2 – Nëntabelë e lidhur me seksionin e përllogaritjes së faktorit të madhësisë

Kujdes: Ky është një sistem me bazë formulash, nuk duhet të ndryshohen vlerat apo të hidhen të dhëna në këtë tabelë.

Kategoria	Madhësia			Komente
	Vogel	Mesëm	Madh	
	1-3 pers.	4-6 pers.	>6 pers.	
Familje	0%	+ 40%	+ 80%	
	15	30	> 30 punonj., për çdo punonj. shtesë.	Sipas studimeve të ADEME (Francë), sasia e mbetjeve të gjeneruara nga një punonjës përfaqëson 20% të mbetjeve të gjenruara nga një person në familje. => 5 punonjës = 1 një person në familje
Institucion	+ 20%	+ 60%	+ 2.7%	Për e vogël në të mesme = +40% për 15 persona = +2.7% për person
	50	100	> 100 m2, për çdo 50 m2 shtesë	
Biznese kat. 1	+ 20%	+ 40%	+ 20%	Kategoria 1, përfshin kategoritë: Shërbime, profesione të lira dhe ambulantë*
Biznese kat. 2	+ 40%	+ 60%	+ 20%	Kategoria 2, përfshin kategoritë: Shitje me pakicë, shitje më shumicë dhe transport
Biznese kat. 3	+ 60%	+ 80%	+ 20%	Kategoria 3, përfshin kategoritë: Prodhim

*) Shpërndarja e bizneseve brenda kategorive është bazuar në legjislacionin shqiptar për taksat, duke i kombinuar kategoritë e biznesit dhe veprimtarinë e tyre. Shpërndarja e bizneseve në kategori nuk kazohet në kategorinë i madh apo i vogël, por vetëm në fushën e veprimtarisë që shpjegohet më lart. Referenca ligjore është sipas ligjit Nr.8978, datë 12.12.2002 "Për taksën vendore për biznesin e vogël" dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr. 4 datë 27.01.2003 "Për taksën vendore mbi biznesin e vogël".

3.3.4 Shpjegimi i faktorëve të përdorur në tabelat më sipër dhe mënyra e përdorimit të tyre

a) Faktori oborr

Futja e këtij faktori vjen nga vëzhgimi që është bërë në njësitë e qeverisjes vendore të mëdha (p.sh. Shkodrës), ku një pjesë e rëndësishme e mbetjeve është vegjetale dhe vijnë nga kopshtet individuale. Eliminimi i këtyre mbetjeve vegjetale, që shpesh janë shumë voluminoze, kushton shumë për njësinë. Kjo kosto shtesë duhet të mbështetet nga pronarët e këtyre oborreve. Kjo është arsyeja pse modeli propozon dyfishim të faktorit referencë (+100%) për gjeneruesit të cilët kanë një oborr. Përdorimi i këtij faktori ofron një qasje progresive për të krijuar një komunikim me komunitetin, e cila e kombinuar me "faktorin e nxitjes" (aplikimit të masave ligjore për zvogëlimin e tarifës), ofron një nxitje për kompostimin dhe zgjidhje të tjera.

Lidhur me këtë faktor, NJQV duhet të konsiderojë si më poshtë:

Cila është përqindja e mbetjeve vegjetale që vijnë nga kopshtet?

Sa ndikon kjo në koston e shërbimit (grumbullimit, transportit dhe të depozitimit)?

Modeli i propozon shkallën e ndikimin si mëposhtë të faktorit oborr për llogaritjen e tarifave, por proporcionet mund të përshtaten nga vetë njësia:

Kategoria	Oborri	
	Jo	Po
Familje	+ 0%	+ 100%
	-	Oborr = gjenerim i lartë mbetjesh
Institucion	+ 20%	+ 100%
	Masë mbështetëse	Oborr = gjenerim i lartë mbetjesh
Biznes	+ 20%	+ 100%
	Masë mbështetëse	Oborr = gjenerim i lartë mbetjesh

Një vlerë bazë prej +20% aplikohet mbi tarifën për bizneset dhe institucionet, për të mbështetur uljen e barrës për popullatën.

b) Faktori madhësi

Ky faktor supozon se sasia e mbetjeve të gjeneruara ndikohet nga "madhësia" e prodhuesit. Faktori i madhësisë përllogaritet në mënyrë të ndryshme për çdo kategori gjeneruesish.

Familjet

Gjenerimi i mbetjeve është në proporcion me numrin e njerëzve që jetojnë në familje. 3 kategori janë propozuar.

Modeli i propozon ndikimin e mëposhtëm të faktorit madhësi në llogaritjen e tarifës:

Kategoria	Madhësia		
	Vogël	Mesme	Madhe
	1-3 pers.	4-6 pers.	>6 pers.
Familje	0%	+ 40%	+ 80%

Koeficientët mund të përshtaten nga NJQV, sipas kushteve dhe politikave vendore.

Institucionet[1]

Kategoritë janë përcaktuar në bazë të numrit të të punësuarve, në bazë të kritereve të përcaktuara për familjet (5 punonjës janë konsideruar si 1 person i një familje). Këto kategori mund të ndryshohen në përputhje me njohuritë lokale të institucioneve.

Ndërsa për faktorët e tjerë, një bazë minimale prej 20% është aplikuar në llogaritjen e tarifave për të gjitha institucionet. Për një numër të mesëm punonjësish, aplikohet një shtesë prej 40% dhe për më tej një vlerë prej 2,7% aplikohet për çdo punonjës shtesë kur institucioni është më shumë se 30 punonjës.

Tabela mëposhtë paraqet mënyrën si bëhet kjo përllogaritje në excel

Kategoria	Madhësia		
	Vogël	Mesme	Madhe
	1 – 15 pers.	16-30	> 30 puno. për çdo punonj. shtesë
Institucione	+ 20%	+ 60%	+ 2.7%

Një tavan prej +900% është vendosur (rregullohet me anë të formulës), në mënyrë që ndalohet rritja e mëtejshme e këtij ky faktori kur ai çon në një faktor të faturimit më të lartë se dhjetë herë faktorin referencë të faturimit. Kjo do të thotë se mbi 345 të punësuar, ky faktor nuk do të rritet më. Mundësia e kufizimit të këtij faktori është në dorë të NJQV për ta përdorur.

Bizneset

Për përcaktimin e faktorit të madhësisë, në bazë të përvojës me këtë kategori gjeneruesish, është bërë ndarja e tyre në 3 kategori, mbështetur në grupimet që bëhen nga ligji për taksat vendore[2,3]:

Kategoria 1 Gjeneruesi në shkallë të vogël të mbetjeve, ku hyjnë: Shërbimet, profesionet e lira dhe ambulantët

Kategoria 2 Gjeneruesi në shkallë të mesme të mbetjeve, ku hyjnë: Dyqane me pakicë, dyqanet me shumicë dhe transporti

Kategoria 3 Gjeneruesi në shkallë të lartë të mbetjeve, ku hyjnë: Prodhimi

Këtu koeficienti është i bazuar në sipërfaqen e ndërtesës (vetëm truall) të përdorur nga biznesi. Njësia bazë minimale është 50 m2, e cila mund të ndryshohet në përputhje me njohuritë lokale.

Për faktorët e tjerë: një bazë prej 20% aplikohet në llogaritjen e tarifave për të gjitha bizneset; +40% për kategorinë e dytë dhe 60% për kategorinë e tretë. Pastaj, koeficienti është në rritje 20% për çdo 50 m^2 shtesë.

Tabela mëposhtë paraqet mënyrën si bëhet kjo përllogaritje në excel

Kategoria	Madhësia			
	Vogël		Mesme	Madhe
		sip. e biznesit : 0-50 m^2	sip. e biznesit: 50-100 m2	> 100 m^2, për çdo . 50 m^2 shtesë
Biznese kat. 1	prodh. i ulët	+ 20%	+ 40%	+ 20%
Biznese kat. 2	prodh. i mesëm	+ 40%	+ 60%	+ 20%
Biznese kat. 3	prodh. i lartë	+ 60%	+ 80%	+ 20%

Një tavan prej +900% është përcaktuar, në mënyrë që të ndalohet rritja e mëtejshme e këtij faktori kur çon në një faktor të faturimit më të lartë sa dhjetë herë faktori referencë i faturimit. Kjo do të thotë se mbi 2.250 m^2, ky faktor nuk do të rritet më. Mundësia e kufizimit të këtij faktori është në dorë të NJQV për ta përdorur.

c) Faktori distancë[4]	Ndërtimet e shpërndara kudo janë një burim i shpenzimeve të larta për shërbimet publike, duke përfshirë menaxhimin e mbetjeve. Ideja e këtij faktori në distancë është që të reflektojnë koston shtesë për komunitetin për mbledhjen dhe transportin në distancë "të largët". Megjithatë, distanca nuk ka të bëjë me me gjenerimin e mbetjeve dhe prodhuesi nuk ka asnjë ndikim mbi të. Kjo është arsyeja pse koeficientët e propozuar nuk janë shumë të lartë (20% për çdo hap). Lidhur me përdorimin e këtij faktori, NJQV duhet të marrin në konsideratë si në vijim: Kategoritë dhe koeficienti duhet të përshtaten me cilësitë e veçanta të NjQV (shpërndarjen, nivelin ekonomik, kapacitetet teknike, etj.) Cila është politika e NjQV-së në lidhje me menaxhimin e territorit? A ka një vullnet për përqendrim e ndërtimeve? Nëse po, koeficienti mund të jetë më i lartë që të nxisë këtë politikë. Sa e ndikojnë gjeneruesit e mbetjeve në distancë të largët koston e shërbimit (grumbullimin, transportimin dhe depozitimin)? Të merret në konsideratë se disa klientë me të ardhura të ulëta mund të gjenden larg për shkak të disa arsyeve, duke përfshirë edhe ato ekonomike (fshatrat e largëta). Vëmendje e veçantë u duhet kushtuar klientëve që janë jashtë zonës së shërbimit, ose të keq shërbyer (reduktim tarifor apo përjashtim).

d) Prodhues "i madh" ose i veçantë	Ky faktor është më i rëndësishëm për bizneset dhe institucionet sesa familjet. Ai është futur për të kompensuar situatën ku prodhuesi nuk ka kopësht, ka marrë me qira një ndërtesë të vogël me pak të punësuar në qendër të qytetit, por prodhon sasi të madhe të mbetjeve, për shkak të natyrës së veprimtarisë së tij. Në këtë rast, nëse do të bazohej vetëm në faktorët, kopësht madhësi dhe distancë, ky gjenerues do të paguante tarifë shumë të ulët. Ky faktor i jep mundësinë NjQV-së që të rregullojë shkallën e tarifës, në mnëyrë të tillë që t'i përgjigjet shkallës së ndikimit të këtij biznesi në menaxhimin e mbetjeve. Si një vendim teknik dhe politik, NJQV duhet të marrin në konsideratë si në vijim: Vendimi për të përcaktuar si një gjenerues të madh një biznes i takon NJQV-së dhe bazohet në vlerësimin teknik të bërë nga administrata. Ky është gjithashtu një instrument për nxitjen e praktikave të mira. Krahasuar me bizneset e tjera apo institucionet të njëjtën game gjenerimi (në lidhje me madhësinë), sa më shumë mbetje këta gjenerojnë? 2, 5, 10 herë më shumë? Kjo mund të jetë një bazë për të zgjedhur koeficientin e duhur.

e) Faktori për masat zbutëse (incentivat)	Ky faktor jep mundësinë për të ulur tarifën e gjeneruesit, i cili aplikon masa ligjore dhe të miratuara nga NJQV në reduktimin e sasisë së mbetjeve. NJQV-ja mund të propozojë një listë të masave që duhet të zbatohen për të përfituar nga ky faktor, si për shembull: Të ndajë letrën/amballazin dhe PET/plastikën dhe të nxjerrë këto rryma mbetjesh në rrugë vetëm në ditët e përcaktuara nga NJQV-ja (në rast se njësia e aplikon këtë strategji) Të bëjë kompostim mbetjesh Të përdorë zgjidhje të veçanta dhe private ! Marrja e informacionit mund të jetë e komplikuar dhe të marrë shumë kohë! Ky faktor mund të konsiderohet i vështirë për t'u përdorur dhe për më tepër për t'u faktuar. Një mënyrë do të ishte, që vetë klienti të faktojë punën që bën dhe arsyen pse e meriton të përfitojë nga kjo zbritje. Lidhur me këtë faktor, NJQV duhet të konsiderojë si vijon: Çfarë lloj masash dëshiron të mbështesë NJQV-ja? Cili është ndikimi i kësaj mase? Sa reflektohet ajo në kosto (uljen e saj)?

Poshtëshënime nga tabela

1) Sipas studimeve të ADEME (Francë), gjenerimi i mbetjeve nga 1 punëtor përfaqëson 20% të mbetjeve të gjeneruara nga 1 person në familje. => 5 punonjës = 1 person në kategorinë familje

2) Ligj Nr.8978, datë 12.12.2002 "Për taksën vendore të biznesit të vogël", i ndryshuar
3) Ministria e Financave Urdhër Nr. 4, Datë 27.01.2003 "Për taksën vendore të biznesit të vogël"
4) Me distancë nga qendra e qytetit apo komunës do të kuptojmë rrezen e largësisë nga kjo qendër deri tek gjeneruesi/klienti (distancën lineare në km), jo distancën që kryen kamioni rrugës duke grumbulluar deri në destinacion.

3.3.4.1 Fleta 1 – Përcaktimi i faktorëve të faturimit për secilin klient

Tabela 7 – Hapi 3: Atribuimi i nivelit të tarifës për çdo klient - përcaktimi i faktorit të faturimit (shembull).

Nën secilën kategori, listoni klientët (duke përdorur të dhënat e mbledhura nga burimet e përmendura më lart). Për secilin nga klientët, vlera e parametrave duhet të përcaktohen një e nga një, në mënyrë që të llogaritet faktori i faturimit në fund të tabelës. Për familjet në ndihmë sociale, nëse zgjidhni "po" faktori i faturimit do të bëhet = 0.

Kujdes: mos dëmtoni formulat në çdo qelizë. Hapja e rreshtave të rinj, duhet të shoqërohet dhe me aplikimin e formulave të rreshtit të parë në excel.

Lista e klientëve	Oborri	Faktori	Madhësia	Faktori	Distanca	Faktori	Prodhues i madh	Faktori	Masa reduktuese	Faktori	Përja-shtimi për arsye sociale	Faktori total i faturimit
	Po/Jo	[-]	[banor], [punonj.] or [m2 pronë]	[-]	[km]	[-]	Po/Jo	[-]	Po/Jo	[-]	Po/Jo	[-]
Familjet (kryefamiljari/ja)												
Z. xyz	yes	+ 100%	7	+ 80%	2	+ 0%	no	+ 0%	no	-0%	yes	0.0
Znj. stu	yes	+ 100%	5	+ 40%	3	+ 0%	no	+ 0%	yes	-20%	no	2.2
…												
Institucionet												
Institucion I1	yes	+ 100%	31	+ 63%	1	+ 20%	no	+ 20%	yes	-20%	no	2.8
Institucion I2	no	+ 20%	345	+ 900%	4	+ 20%	no	+ 20%	no	-0%	no	10.6
…												
Biznese kategoria 1												
Biznes B1.1	no	+ 20%	2250	+ 900%	5	+ 20%	no	+ 20%	yes	-20%	no	10.4
Biznes B1.2	no	+ 20%	60	+ 40%	12	+ 60%	yes	+ 100%	yes	-20%	no	3.0
Biznese kategoria 2												
Biznes B2.1	no	+ 20%	1000	+ 400%	5	+ 20%	no	+ 20%	yes	-20%	no	5.4
Biznes B2.2	no	+ 20%	30	+ 40%	12	+ 60%	yes	+ 100%	no	-0%	no	3.2
Biznese kategoria 3												
Biznes B3.1	no	+ 20%	350	+ 140%	5	+ 20%	no	+ 20%	no	-0%	no	3.0
Biznes B3.2	no	+ 20%	100	+ 80%	12	+ 60%	yes	+ 100%	no	-0%	no	3.6
Total												46.4

3.3.4.2 Sheet 2 – Përllogarit tarifën

Në fletën tjetër të excel jepet tabela e përllogaritjes së faturës në vlerë monetare. Kjo tabelë i merr të dhenat e nevojshme nga fleta e sipërshpjeguar e excel. Përdoruesi mund të analizojë formulat përkatëse pë rtë parë se ku lidhet çdo qelizë e kësaj tabele.

Tabela 8 - Hapi 4: Sheet 2 – Përllogaritja e tarifës referencë - (shembull).

Të dhënat bazë	Vlera	Njësia	[Vlera] e shpjeguar
Kostoja e buxhetit			
Buxheti total i menaxhimit të mbetjeve	80.000.000	Lek/vit	Kostoja totale që shpenzon njësia për mënaxhimin e mbetjeve në vit
Klientët			
Të dhënat mëposhtë vijnë nga tabela e mësipërme (sheet 1)			
Numri i njësive të faturimit	46,4	njësi	Grumbullohen nga formula. Numri mblidhet nga shuma e të gjitha njësive të faturimit të prodhuara nga tabela e mësipërme tek Sheet 1.
Shkalla totale e mospagimit	30	%	Përqindja totale e tarifës që nuk mblidhet. Kjo shifër i shpërndahet të gjithë paguesve të rregullt. NJQV-ja mund ta subvencionojë këtë shumë, në vend që ta rishpërndajë
Përllogaritja e tarifës bazë/referencë			
Frekuenca e tarifimit	2	Fatura/ vit	
Tarifa referencë	1400	Lek/ faturë	Kjo tarifë do të paguhet nga të gjithë klientët, të cilët kanë faktorin e faturimit të barabartë me 1.
Tarifa referencë, duke përfshirë dhe shkallën e mospagesës	1800	Lek/ faturë	Kjo është tarifa bazë reale, e cila merr në konsideratë dhe shumë totale të mospagimit, për të arritur mbulimin total të kosots së shërbimit.

Tabela 9 – Hapi 5 – Sheet 2 – Përllogaritja e tarifës për çdo klient (shembull)

Të dhënat këtu janë të lidhura me Tabelën 7 të Sheet 1. Këtu nuk ka nevojë për të shtuar dhe një herë manualisht listat e klientëve, pasi ato janë të populluar me formulën përkatëse, e cila i merr të dhënat nga tabela në Sheet 1. Për të llogaritur tarifën, përdoruesi duhet të shtojë aq rreshta sa ka klientë në kategori, të cilët janë të listuar në Tabelën 7 të Sheet 1. Pastaj, zgjidhni rreshtin e parë të kategorisë (e cila ka formulat të pa dëmtuara, të jeni të kujdesshëm për të mos humbur këtë rresht) dhe terhiq poshtë, duke përdorur metodën e excel për popullimit qelizat me të njëjtën formulë në metodë progresive. Ju do të vini re se rreshtat e modelit janë vetë populluar. Duke bërë kështu, të gjithë klientët dhe faktorët e faturimit do të shfaqen në qelizat përkatëse dhe tarifa do të llogaritet vetë.

Klientë			Faktori i faturimit	Fatura	
Familje					
Z. xyz			0.0	-	Lek/faturë
Znj. stu			2.2	338	Lek/faturë
…					
Institucione					
Institucion I1			2.8	435	Lek/faturë
Institucion I2			10.6	1,631	Lek/faturë
…					
Biznese nën kategorinë 1					
Biznes B1.1			10.4	1,6000	Lek/faturë
Biznes B1.2			3.0	4620	Lek/faturë
Biznese nën kategorinë 1					
Biznes B2.1			5.4	8310	Lek/faturë
Biznes B2.2			3.2	4920	Lek/faturë
Biznese nën kategorinë 1					
Biznes B3.1			3.0	4620	Lek/faturë
Biznes B3.2			3.6	5540	Lek/faturë
…			…	…	
Totale faturim për 1 periudhë (x muaj)	x =	6	46.4	7,1430	Lek/per.
Shuma totale e faturimit për një vit				14,2850.71	Lek/vit
Të ardhura (nëse shuma e mospagimit = shumë e përllogaritur):				10,0000	Lek/vit

CAPITOLE
santé
La vale
refuge